

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 17 / verë 2019

Editorial 2

Gëzim Spahija

Çfarë iu Mëson Jezusi Burrave Rreth Parasë, Pushtetit dhe Marrëdhënieve Seksuale 3

George Paul Wood

Ta Doni Bashkëshorten Tuaj Ashtu si Krishti e Deshi Kishën: Çfarë iu Mëson Pali Bashkëshortëve Rreth Martesës 8

Fred Stoeker

Përgjegjësia e Udhëheqësve Shërbëtorë 17

H. Maurice Lednicky

Udhëheqje Vendimtare: Një Matricë Biblike Për Të Gjetur Urtësi 23

Robert C. Crosby

Gjigandët në Mesin Tonë 29

Jeff Dove

Tema: Burrat në Shërbesë



Burrat në Shërbesë

Njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, dhe në ngjasim me të. “Kështu, Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën”. Pra, burri duhet të jetë sipas zemrës së Perëndisë, gjithmonë i gatshëm për të falur, për të shërbyer dhe për të sjellë shërim. Ai e tregon çdo ditë se është shembull i sovranitetit të Perëndisë dhe se nuk duhet të komprometohet ndaj mëkatit.

Burrat në shërbesë apo burrat në betejë?

Shërbesa e parë dhe e mençur e çdo burri që Perëndia kërkon, është në radhë të parë ndaj familjes së tij. Ai, si kreu i familjes duhet të jetë sigurus çdo ditë, si për nevojat frymërore, ashtu edhe për ato materiale, duke e dëshmuar me jetën e tij, dashurinë dhe besnikërinë e Perëndisë. Atij i duhet që të jetë një ndërmjetësues dhe një luftëtar i vendosur. Ai lufton në çdo moment për familjen dhe këmbëngul derisa të marrë fitoren, duke e dashur dhe duke e mbrojtur atë. Ai e ngushëllon gruan dhe familjen e tij, i shërben dhe i mbron këto të dyja, në çdo aspekt.

Burrat, si udhëheqës, ushtrojnë me dashuri autoritetin e dhënë nga Perëndia, siç është shkruar tek Letra e Parë Drejtuar Korintasve, 11:3: “*Por dua që të dini se kreu i çdo burri është Krishti*”. Duhet, që në çdo situatë, ata të ruajnë unitetin e Frymës, duke pasur paqe dhe siguri të plotë nën autoritetin e Krishtit, i Cili është kreu i Kishës,

duke evituar kritikën, të luftojnë doktrinat e rreme dhe të predikojnë e të jetojnë në dashuri. Atyre iu duhet që, në radhë të parë, të kenë thirrje të veçantë për t’i shërbyer Zotit, pastaj për t’u kujdesur për tufën. Zoti, së bashku me thirrjen, do t’u japë atyre edhe cilësitë e nevojshme si: aftësi, dituri, forcë, durim, për të vigjiluar dhe për të treguar kujdes për frymërat. Jeta praktike e tyre duhet të jetë zbatimi i Fjalës së Zotit që ata predikojnë, duke mos qenë të ndikuar nga rrymat e ndryshme apo nga opinionet publike. Ata janë ambasadorë të Krishtit, me detyrë që ta mbajnë dhe ta përcjellin të pastër Fjalën e Jetës.

Kisha e Zotit, pikërisht sot, ka nevojë për burra të perëndishëm, të cilët, të mbushur plot me dashurinë e Zotit, i lënë mënjane përfitimet e tyre personale, për t’u kujdesur për mirëqenien e popullit të Zotit. Ata nuk i braktisin vëllezërit, por me dashuri interesohen për të vizituar të sëmurët, të plagosurit në shpirt, të lodhurit, të dobëtit, të dekurajuarit, pleqtë, jetimët dhe vejushat.



GËZIM SPAHIJA, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 17
Verë 2019

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: (+355) 69-406-8956
Email: KTUShqiperi@gmail.com




Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Çfarë iu mëson Jezusi burrave *rreth* **PARASË, PUSHTETIT** *dhe* **MARRËDHËNIEVE SEKSUALE?**

Nga: **GEORGE PAUL WOOD**



Cila ishte, për Jezusin, shenja dalluese parësore e burrërisë? Dhe në bazë të asaj shenje dalluese, çfarë iu mëson Jezusi burrave të krishterë për sa i përket parasë, marrëdhënieve seksuale dhe pushtetit?

Në rast se i kërkon një burri që të përkufizojë suksesin në jetën e vet, ka shumë mundësi që përgjigja e tij do të përfshijë ndonjë variacion të këtyre tri temave: paraja, marrëdhëniet seksuale dhe pushteti. Në qoftë se një burrë ka një vend pune, ka marrëdhënie me një grua dhe zotëron një aftësi, e cila e veçon atë nga turma, atëherë njerëzit e konsiderojnë atë të suksesshëm.

Sigurisht, ai mund t'ia dalë për një kohë të shkurtër pa njërën prej këtyre gjërave, ose pa dy apo pa të tria, por kjo mungesë nuk ka për të ndikuar në vetë-vlerësimin e tij. Por ama, nëse ai nuk i ka këto gjëra për një periudhë të gjatë kohore, atëherë ai fillon të vërë në pikëpyetje burrërinë e tij. Nuk mjafton të jesh një burrë, por duhet të jesh burrëror. Nuk mjafton të jesh një mashkull, por duhet të jesh mashkullor.

Shenjat dalluese të burrërisë, pra, paraja, marrëdhëniet seksuale dhe pushteti, janë po ashtu të vërteta edhe për burrat e krishterë, me disa kufizime. Puna duhet të jetë e ndershme, marrëdhënia seksuale duhet të jetë brenda martesës dhe aftësitë e secilit duhet të përdoren për t'i sjellë lavdi Perëndisë. Për më tepër, paraja, marrëdhëniet seksuale dhe pushteti për burrin e krishterë, janë njësi matëse dytësore të suksesit. Njësia e vërtetë që mat suksesin është marrëdhënia që ai burrë ka me Jezu Krishtin.

Por këtu, burrat e krishterë përballen me një problem të vështirë: Jezusi ishte i varfër (Mat 8:20), i pamartuar (Mat 19:12), dhe ishte shërbëtor (Mat 20:28). Në rast se paraja, marrëdhëniet seksuale dhe pushteti janë shenja dalluese të burrërisë, edhe në kuptimin dytësor të tyre, atëherë duhet të dalim në përfundimin se, për disa aspekte të rëndësishme, Jezusi dështoi të ishte mashkullor.

Patjetër që është e dukshme se, një përfundim i tillë, nuk ka baza dhe nuk mund të mbrohet. Jezu Krishti është Fjala që u bë mish, Biri i Perëndisë, Adami i dytë, Zoti i qiellit dhe i tokës. Në qoftë se shenjat tona dalluese të burrërisë e nxjerrin Jezusin jo shumë mashkullor, atëherë gabimi është te standardi ynë i matjes, jo te standardi i Tij.

Atëherë, cila ishte, për Jezusin, shenja dalluese parësore e burrërisë? Dhe në bazë të asaj shenje dalluese, çfarë iu mëson Jezusi burrave të krishterë lidhur me paranë, marrëdhëniet seksuale dhe pushtetin?

NJË SQARIM I DOMOSDOSHËM

Duke u fokusuar tek ajo që Jezusi iu mëson burrave të krishterë lidhur me burrërinë, nuk është qëllimi im të nënkuptoj se mësimet e Jezusit gjejnë zbatim vetëm tek burrat. Ftesa që Jezusi bëri: "Më ndiqni", iu është dhënë të gjithë njerëzve, pavarësisht nga gjinia (Marku 8:34; krah. Luka 8:1-3; 23:49).

Gjithashtu nuk është qëllimi im që të nënkuptoj se Jezusi nuk ka asgjë për t'u mësuar grave të krishtera rreth të qenit grua. Sepse, nuk është kështu dhe në fakt Jezusi e bën këtë gjë (p.sh. tek Luka 10:38-42). Për qëllimet e këtij artikulli, unë thjesht po shoh se çfarë u mëson burrëria e Jezusit burrave të krishterë në lidhje me burrërinë e tyre, kur vjen puna tek temat e parasë, marrëdhënieve seksuale dhe pushtetit.

SHENJA DALLUESE PARËSORE

Duke pasur ndërmend këtë sqarim të domosdoshëm, i kthehem sërish pyetjes së parë: Cila ishte, për Jezusin, shenja dalluese parësore e burrërisë?

Në fillim të shërbesës së Tij, Jezusi shpalli: "U mbush koha dhe mbretëria e Perëndisë është afër. Pendohuni dhe besoni në ungjillin" (Marku 1:15).

Në sytë e Jezusit, sipas sugjerimit tim, masa e suksesit në jetë është nëse një person, qoftë mashkull apo femër, e pranon ose jo sundimin e Perëndisë në jetën e tij apo të saj. Suksesi i vërtetë varet tek besimi te Krishti, i cili me personin dhe veprat e veta mishëron Mbretërinë e Perëndisë (Mateu 7:21-23).

Nga kjo perspektivë, atëherë, një burrë i cili ka para, përmbushet seksualisht dhe zotëron pushtet, por që nuk ka mbretërinë, ka dështuar të jetë ai lloj burri, ashtu siç i do Perëndia që të jenë burrat. Natyra e tij mashkullorë nuk është e perëndishme, por është sipas botës, dhe për këtë arsye, nuk përbën ndonjë rëndësi të përjetshme. Në të njëjtën mënyrë, një burrë i cili e ka mbretërinë, por nuk ka para, nuk kryen marrëdhënie seksuale apo nuk posedon pushtet, ia ka arritur të jetë burrë i Perëndisë, sepse jeta e tij ka rëndësi të përjetshme.

Siç tha edhe Jezusi: "Kushdo që do të vijë pas meje, ta mohojë vetveten, ta marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë, sepse ai që do të shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do të humbasë jetën e vet për

Në sytë e Jezusit, masa e suksesit në jetë është nëse një person, qoftë mashkull apo femër, e pranon ose jo sundimin e Perëndisë në jetën e tij apo të saj.



hirin tim e për ungjillin” - mbani mend, ungjilli është shpallja e mbretërisë së Perëndisë - “do ta shpëtojë. Ç’dobi do të ketë njeriu të fitojë të gjithë botën, dhe të humbë shpirtin e vet? Ose çfarë mund të japë njeriu në shkëmbim të shpirtit të vet?” (Mk 8:34–37).

Në qoftë se shenja dalluese parësore e burrërisë së vërtetë është pranimi i Mbretërisë, atëherë si i përdor paratë, marrëdhëniet seksuale dhe pushtetin një burrë i Mbretërisë? Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, le të marrim në konsideratë episodet në vijim të cilët janë nxjerrë nga ungjijtë.

SHËMBËLLTYRA E PASANIKUT TË PAMEND (LUKA 12:13–21)

Episodi i parë fillon kur një burrë u përpoq të shfrytëzonte ndikimin e Jezusit për përfitime financiare: “Mësues, i thuaj vëllait tim ta ndajë me mua trashëgiminë”.

Jezusi u përgjigj fillimisht duke mos pranuar të kishte ndonjë autoritet ligjor, të dhënë nga njerëzit, që të mund ta bënte një gjë të tillë: “Njeri, kush më vuri mua gjykatës ose ndarës përmbi ju?”.

Përgjigja e dytë e Jezusit nxori në pah një temë më të gjerë në lidhje me ndikimin tejet të madh të parave në mendësinë tonë: “Kini kujdes dhe ruhuni nga lakmia, sepse jeta e njeriut nuk qëndron në mbushullinë e gjërave që zotëron”. (Të dyja përgjigjet tregojnë tendencën njerëzore për të shpërdoruar religjionin me qëllim që të justifikojnë lakminë e tyre).

Përgjigjen e Tij të dytë, Jezusi e ilustron me një shëmbëlltyrë: “Tokat e një pasaniku dhanë të korra të bollshme”. (Vini re se si Jezusi ia jep tokës meritat për të korrat, dhe jo aftësive të njeriut. Kjo është një kujtesë e përlur për burrat, që sukcesi në çdo përpjekje të singertë, shpeshherë varet nga forca që nuk janë nën kontrollin tonë).

Për shkak se e korra e tejkalonte kapacitetin magazinues të hambarëve të tij, ky burrë i hedh në

tokë hambarët e vjetër dhe ndërton hambarë të rinj, edhe më të mëdhenj. Pastaj i thotë vetes: “Ti ke të mira të shumta të vëna për shumë vjet; pusho, ha, pi dhe gëzohu”.

Mirëpo, perspektiva e Perëndisë mbi këtë çështje ishte goxha ndryshe nga ajo e burrit: “O i pamend, këtë natë shpirti yt do të kërkohet dhe ato që përgatite të kujt do të jenë?”.

Jezusi e përmbyll shëmbëlltyrën duke treguar se cili ishte morali i saj: “Kështu i ndodh atij që grumbullon thesar për vete dhe nuk është i pasur ndaj Perëndisë”.

Sipas mënyrës siç mendonte Jezusi, pra, perspektiva e burrit të Mbretërisë, të qenit i pasur ndaj Perëndisë do të thoshte të qenit zemërgjerë karshi të varfërve. Ai e përshkroi zemërgjerësinë karshi të varfërve si një donacion (ose dhuratë) në arkën e thesarit të qiellit, si një investim i cili do të paguajë dividendë (pagesë në bazë të investimit) në jetën që do të vijë.

Jezusi tha: “Shitni ç’të keni tuajën dhe jepni lëmoshë! Bëni për vete kuleta që nuk vjetrohen, një thesar të pashtershëm në qiejt, ku vjedhësi nuk afrohet dhe tenja nuk bren” (Luka 12:33).

Prandaj, kur vjen puna tek paraja, të qenit burrë, të paktën sipas mënyrës si e sheh Jezusi, ka të bëjë shumë pak me sasinë e parave që dikush fiton, dhe më shumë me sasinë e parave që ai person jep; më pak me ngjitjen lart të shkallëve, dhe më shumë me zemërgjerësinë për ata persona që janë më poshtë. Një burrë i krishterë mund të fitojë aq para sa e lejojnë aftësitë dhe mundësitë që i jepen nga Perëndia, por, këto para, ai duhet t’i përdorë për përfitimin e të tjerëve, në radhë të parë, të familjes së tij, dhe pastaj të të varfërve (Letra e Parë Drejtuar Timoteut 5:8; 6:17–19). Atëherë, shenja dalluese e burrërisë së vërtetë, është përdorimi me zemërgjerësi i parave, dhe jo thjesht zotërimi i tyre.

MËSIMET LIDHUR ME DIVORCIN (MAT 19:3–12)

Episodi i dytë fillon me disa farisenj, kur ata “vënë në provë” Jezusin, duke e pyetur Atë lidhur me divorcin: “A është e lejueshme që burri ta lërë gruan e tij për një shkak çfarëdo?”.

Tani, për të kuptuar përgjigjen e Jezusit, na duhet të mbajmë mend dy shkollat e mendimit rreth divorcit të cilat mbizotëronin në mesin e hebrenjve në kohën e Jezusit. Shkolla e Hilelit mbante anën e një kuptimi më liberal të divorcit. Sipas interpretimit të kësaj shkolle, për sa i përket gramatikës së përdorur te LiP 24:1, ky varg e lejonte burrin të divorcohej mbi këto dy baza: “[çdo gjë] që nuk e kënaq më” dhe “diçka të turpshme”. Shkolla e Shamait, nga ana tjetër, mbante anën më konservatore të këtij debati. Ata e interpretonin LiP 24:1 si një varg i cili e lejonte burrin të divorcohej mbi një bazë: “[çdo gjë] që nuk e kënaq më, sepse ai ka gjetur në të diçka të turpshme”.

Jezusi, në vend që ta rrënjoste përgjigjen e Tij tek “trillet” e gramatikës hebraike, Ai e themeloi përgjigjen që dha tek historitë e krijimit nga Zanafilla 1 dhe 2. “Ai, duke iu përgjigjur u tha atyre: ‘A nuk keni lexuar, se ai që i krijoi që në fillim, i krijoi mashkull dhe femër?’ [Zanafilla 1:27] dhe tha: ‘Për këtë arsye njeriu do ta lërë të atin dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet; dhe të dy do të jenë një mish i vetëm’ [Zanafilla 2:24]. Kështu që nuk janë më dy, por një mish i vetëm; atë, pra, që Perëndia ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë”.

Argumenti që Jezusi dha nga krijimi e pozicionoi Atë në të njëjtën anë të debatit të divorcit me Shamaistët: “Unë ju them se kushdo që e lë gruan e vet, përveç rastit të kurvërisë, dhe martohet me një tjetër, shkel kurorën”. Kjo përgjigje shtangu edhe vetë dishepujt e Tij: “Në qoftë se kushtet e burrit ndaj gruas janë të tilla, nuk ia leverdis të martohesh”.

Shpeshherë, edhe më tepër seç duhet në fakt, ne nuk arrijmë që të vëmë re se sa pikëpamje ego-centrike dhe të përqendruar tek meshkujt kishin dishepujt e Jezusit në lidhje me martesën dhe divorcin. Në të vërtetë, ata ishin duke thënë: “Në rast se një burrë nuk mund ta lërë gruan e tij për çfarëdo shkak apo arsyeje, atëherë nuk ia leverdis fare që të martohesh”.

Ata i trajtonin bashkëshortet si zotërime që mund t'i hidhnin tej sipas qejfit. Jezusi, nga ana tjetër, u tregoi dinjitet dhe respekt grave, si mbartëse të imazhit të Perëndisë. Dhe Ai pret, që edhe dishepujt e Tij, t'i trajtojnë gratë ashtu siç bëri Ai: “Jo të gjithë i kuptojnë këto fjalë, por ata të cilëve u është dhënë”. Si dishepuj të Jezusit, edhe ne e kuptojmë këtë Fjalë dhe i trajtojmë gratë sipas saj.



Dinjiteti i barabartë që Jezusi u jepte grave, si mbartëse të imazhit të Perëndisë, shpjegon edhe lirinë e jashtëzakonshme që Jezusi ushtronte në marrëdhënien e Tij me gratë, veçanërisht me gra që kishin reputacione të dyshimta seksuale (p.sh., Mateu 21:31, 32; Luka 7:36–50; Gjoni 4:1–42; 7:53–8:11). Kur një burrë nuk i sheh gratë si mjete drejt qëllimeve të përqendruara ndaj vetes së vet, si objekte për të përmbushur dëshirat e veta seksuale, atëherë ai është i aftë që t'i trajtojë ato si të barabarta me të, si shoqe dhe bashkëpunëtoare. Kjo ishte mënyra se si i trajtoi Jezusi gratë. Për shembull, nga njëra anë, Ai e çliroi Martën nga nocioni që, si një grua, ajo ishte e ngjuar në kuzhinë, ndërkohë që burrat bisedonin për Perëndinë. Dhe nga ana tjetër, Ai e miratoi Marinë si një grua në mes të burrave, duke pranuar se ajo “zgjodhi pjesën e mirë, që asaj nuk do t'i hiqet” (Luka 10:42).

Kështu, për sa i përket marrëdhënieve seksuale, Jezusi dëshiron që dishepujt e Tij meshkuj t'i shohin dhe t'i trajtojnë gratë ashtu siç bëri Ai. Jezusi nuk priste që të gjithë dishepujt e Tij të qëndronin të pamartuar, siç ishte Ai vetë (krah. Marku 1:30; Letra e 1 Korintasve 9:5). Por ama, Ai priste që dishepujt e Tij, ata të cilët ishin të martuar, të qëndronin besnikë ndaj bashkëshorteve të tyre. Dhe priste që të gjithë dishepujt e Tij të shmangnin imoralitetin seksual, paçka nëse ishin të martuar apo beqarë. Por, më shumë se kaq, Jezusi priste që dishepujt e Tij, qofshin ata meshkuj apo femra, të kultivonin një pastërti (dëlirësi) të zemrës, e cila e bënte gjithnjë e më të pamundur imoralitetin seksual (dhe mëkatet e tjera [Marku 7:20–23]).



Kjo pastërti e zemrës në lidhje me gjininë e kundërt është shenja dalluese e burrërisë së vërtetë.

GRUAJA ME RRJEDHJE GJAKU (MK 5:21–43)

Episodi i tretë fillon kur një drejtues sinagoge, me emrin Jair, i kërkon Jezusit që të shkojë në shtëpinë e tij dhe t'i shërojë të bijën.

“Tani një grua, që kishte një rrjedhje gjaku prej dymbëdhjetë vjetësh dhe që kishte vuajtur shumë nga mjekë të ndryshëm, duke shpenzuar gjithë pasurinë e vet pa kurrfarë dobie, madje duke u bërë më keq, kur dëgjoi të flitej për Jezusin, u fut në turmë dhe pas shpinës preku rrobën e tij, sepse thoshte: ‘Nëse vetëm prek rrobën e tij, do të shërohem’. Dhe menjëherë iu tha burimi i gjakut të saj dhe ajo kuptoi në trupin e vet se u shërua nga sëmundja”.

“Por menjëherë Jezusi, duke kuptuar në vete që një fuqi kishte dalë prej tij, u kthye midis turmës, dhe tha: ‘Kush m’i preku rrobat?’”.

Shohim dy karakteristika të jashtëzakonshme në këtë histori. Së pari, shohim ndryshimin e plotë të drejtimit të fatit të kësaj gruaje. Sipas Levitikut 15:25-33, kjo grua ishte e papastër, si edhe e sëmurë fizikisht. Kjo papastërti e bënte gruan të papërshtatshme për të marrë pjesë në adhurimin që bëhej në tempull, si edhe, e bënte atë, në kuptimin e plotë të fjalës, të paprekshme, që edhe ata që e preknin atë, veçanërisht burrat, të mos bëheshin gjithashtu të papastër. Kështu pra, fati i saj i keq kishte natyrë fizike, frymërore dhe shoqërore. Prekja shëruese e Jezusit restauroi trupin, frymën dhe marrëdhëniet e saj.

Karakteristika e dytë e jashtëzakonshme është afrimi (apo ngushtimi) i distancës së pushtetit midis një Jezusi të fuqishëm dhe gruas së pafuqishme. Normalisht pushteti e distancoi të fuqishmin nga i pafuqishmi. Por, pushteti i Jez

usit, nga ana tjetër, e afrooi Atë më tepër me gruan me rrjedhje gjaku. Megjithatë Jezusi prekej nga të gjitha anët nga turmat që shtyheshin, Ai ndjeu se fuqia e Tij i shkoi vetëm asaj.

Duke u mbështetur tek kjo histori, unë do të sugjeroja se shenja dalluese e burrërisë së vërtetë është përdorimi i pushtetit për të ndryshuar drejtimin e fateve dhe për të ngushtuar distancat e pushtetit. Në shumicën e shoqërive, burrat kanë një rol më të pushtetshëm sesa gratë. Sociologët i referohen kësaj me termin “privilegj mashkullor”, që është, avantazhi i pamërituar që kanë burrat për shkak të gjinisë së tyre. Këtë pushtet ne mund ta përdorim për ta shkruar këtë privilegj tonin mashkullor mbi ndonjë gur, ose mund ta përdorim atë për të ndërtuar shtëpi, kisha dhe shoqëri të cilat ua ofrojnë të gjithëve këto avantazhe (përfitime). E para është mënyra e botës, ndërsa mënyra tjetër është ajo e Birit të Perëndisë, i cili “nuk erdhi që t’i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblim për shpengimin e shumë vetave” (Marku 10:45).

Përdorimi i pushtetit në shërbim të të tjerëve është shenja dalluese e burrërisë së vërtetë.

PËRMBYLLJA

Pyesni një burrë të krishterë se si e përkufizon ai suksesin në jetë, dhe ai duhet të thotë: “Suksesi në jetë e përkufizoj me anë të pendimit dhe besimit në ungjillin e Jezu Krishtit, që është mbretëria e Perëndisë”.

Si një burrë i Mbretërisë, ai do t’i shpenzojë paratë me zemërgjerësi, do të kultivojë pastërtinë e zemrës nga ana seksuale dhe do ta përdorë pushtetin e tij në shërbim ndaj të tjerëve. Nevoja e madhe e kohës në të cilën jetojmë, kur shohim kaq shumë burra të cilët abuzojnë me paranë, me marrëdhëniet seksuale dhe me pushtetin, është që burrat e krishterë të bëhen burra të Mbretërisë dhe t’i tregojnë botës një rrugë më të mirë.



GEORGE PAUL WOOD,
është redaktor ekzekutiv për publikimet e Asambleve të Perëndisë në Springfield, të shtetit Misuri, SH.B.A.





La doni
dhe
bashkëshorten tuaj


ASHTU SI KRISHTI E DESHI KISHËN:

*Çfarë iu mëson Pali bashkëshortëve
rreth martesës*

Nga: **FRED STOEKER**

A

*keni një bashkëshorte të lavdishme? Dashuria sakrifikuese
prodhon bashkëshorte të lavdishme, të cilat përparojnë në të
qenit një me bashkëshortët e tyre dhe në intimitet me ta. Ja se si
mund t'i ndihmojnë burrat, bashkëshortet e tyre, që të jenë të
lavdishme.*



Si burra të krishterë, e kuptojmë që gratë janë goxha ndryshe nga ne, edhe pse nuk besojmë se këto ndryshime mes gjinive i parandalojnë gratë që të kenë pozita udhëheqëse në kishë. Megjithatë, si bashkëshortë të krishterë, ndodh shumë rrallë që ky qëndrim unik egalitar (d.m.th. në barazi për të gjithë njerëzit) i yni, të ngrihet nga karriget e kishës dhe të vijë bashkë me ne në shtëpi, duke i lënë vendin një zotërimi mashkullor aspak unik, i cili i pengon bashkëshortet tona që të përmbushin pozicionin e tyre të natyrshëm të udhëheqjes në shtëpi, dhe na parandalon neve që t'i duam bashkëshortet tona ashtu siç do Krishti nusen e tij.

Ky është një gabim i rëndë dhe i cili na kushton shumë neve, si bashkëshortë. Në fund të fundit, çdo bashkëshorte ka dhunti jetëdhënëse, të cilat bashkëshorti i vet thjesht nuk i ka. Pra, dhunti që janë vendimtare për suksesin e rolit të tij në martesë. Nëse i lejojmë bashkëshortet tona që të kenë lirinë për të drejtuar përmes mprehtësisë dhe pikave të forta të këtyre dhuntive, atëherë po bekojmë shtëpitë tona, ndërsa bashkëshortet tona rrezatojnë nga gëzimi. Por, nëse nuk e bëjmë këtë gjë, e zbehim atë rrezatim (lavdi) dhe i vjedhim vetes sonë bekimet e shumta që Perëndia dëshiron që ne të kemi si çifte.

Më lejoni që, duke përdorur Brendën, bashkëshorten time, si shembull, t'ju paraqes një tablo të qartë të gabimit tonë si bashkëshortë. Kur ajo ishte beqare, ishte e lirë që të lulëzonte në Krishtin. Kurdoherë që Perëndia e prekte në zemër për të bërë diçka, ajo thjesht e bënte. Kur Perëndia i kërkonte të jepte para për një misionar që kishte nevojë, ajo bindej. Ajo i nderonte pa pengesa bindjet që vinin nga Fryma. Kurdoherë që kishte nevojë për të pushuar, ajo pushonte, dhe lutej kurdoherë që dëshironte. Para martesës, Brenda i shërbente lirisht Perëndisë pa pengesa, duke i përdorur dhuntitë e saj për kënaqësinë e Tij. Ajo ishte e lirë për ta shmangur mëkatën dhe për të jetuar me dëlirësi, dhe kur e kam takuar, ajo ishte aq e bukur saqë rrezatonte në jetën e saj me Krishtin.

E megjithatë, unë vetë ia kam vjedhur asaj këtë liri përmes udhëheqjes sime arrogante dhe sundimit tim mashkullor. Siç bëjnë edhe shumë bashkëshortë të tjerë, unë shkatërrova pikërisht atë rrezatim që më tërhoqi tek ajo si fillim. E thënë më thjesht, unë mëkatova kundrejt Brendës duke krijuar shumë më pak hapësira, për dhuntitë e saj të perëndishme në martesën tonë, nga sa kishte ajo kur ishte beqare. Ç'është më e keqja, e detyrova atë të mëkatonte; diçka, kjo, që askush nuk mund ta bënte përpara se "dashuria" ime të hynte në jetën e saj. Më lejoni të shpjegojem.

Brenda ka dhuntinë e dallimit në lidhje me familjet, që është një dhunti e fortë, të cilën unë nuk e kam. Kur vjen puna të marrëdhëniet familjare, ajo e dallon të mirën nga e keqja (krishterimi në familjen e saj shkon pas në kohë, të paktën katër breza në çdo degë të pemës së saj familjare), dhe prandaj, nuk u ndje aspak rehat me atë që pa në marrëdhëniet e familjes sime, sidomos me vjehrrin dhe vjehrrën e saj. Për shembull, ishte e pashmangshme që unë, pas çdo vizite që i bëja babait tim, të mos largohesha i zemëruar dhe i dëshpëruar për shkak se ai vazhdimisht më ofendonte në prani të bashkëshortes sime. Ndonjëherë, kalonin dy javë derisa të arrija të stabilizohesha nga ana emocionale.

Babai im po shkaktojte dëme në shumë mënyra mbi familjen time të re. Nuk kaloi shumë, dhe madje edhe Brenda filloi, që pas çdo vizite, të përfshihej në të njëjtat dallgë emocionale. Ajo ishte e frikësuar.

"Në rast se unë mund të përpiehem nga kjo vorbull emocionale", tha ajo, "ka shumë mundësi që kjo gjë do t'u ndodhë edhe fëmijëve tanë!".

E njëjta gjë po ndodhte edhe kur shkonim për vizitë tek nëna dhe motrat e mia. Në çdo cep të frymës së saj dëgjoheshin kambanat e alarmit, dhe me shumë të drejtë.

Dhuntia e fortë e Brendës për të dalluar kishte për qëllim të bekonte dhe të mbronte martesën tonë, dhe të më ndihmonte mua të drejtoja mirë qoftë si bashkëshort, qoftë si baba. Ajo e dinte se i duhej të luftonte abuzimin emocional që vinte nga babai im dhe të ndalonte rrëmujën emocionale që shkaktohej nga pjesa tjetër e familjes sime. Por, kaq gjatë kisha jetuar unë me këto gjëra, saqë isha i verbër ndaj rrezikut që më kanosej. Prandaj, ia preva me ftohtësi dhuntinë e saj dhe ia mbylla gojën, që të mos fliste.

"Që një familje të jetë e pranueshme, nuk duhet të jetë patjetër e përsosur si e jotja", deklaroi unë. "Po të ishte rritur në një familje të zakonshme, nuk do të ishte kaq e dobët kur përballesh me gjithë këto gjëra".

Unë e shaja sa herë që ajo bëhej emocionale apo dëshpërohej për çështje të tilla, duke ia goditur zemrën me shprehje të prera si këto: "Sa e përkëdhelur që je! Të rriturit kanë konflikte, dhe duhet të jenë të aftë që të përballesh me to. Prandaj, edhe ti duhet të rritesh".

Por, e vërteta është që ajo nuk ishte e përkëdhelur, dhe nuk ishte aspak e dobët. Ajo po qëndronte e patundur për bindjet që besonte në zemrën e saj. Për bashkëshorten time ishte e qartë që, nënshtrimi i familjes së saj të re ndaj kritikave të shfrenuara të babait tim dhe ndaj ligjëratave akuzuese e idhnake



**Dashuria
sakrifikuese
prodhon
bashkëshorte të
lavdishme, të
cilat përparojnë
në të qenit një
me bashkë-
shortët e tyre
dhe në intimitet
me ta.**

të nënës dhe motrave të mia, në pikëpamjen e saj ishte një mëkat, dhe ky nënshtrim duhej të ishte mëkat edhe për këndvështrimin tim. Por, në vend që t'i bëja vend dhuntisë së saj të dallimit, unë qëndrova i verbër, duke u tallur me dhuntinë e saj dhe duke i kërkuar me zë të lartë që të bënte atë që desha unë të bënte, kur vinte puna tek familja ime. Me pak fjalë, po e urdhëroja që të mëkatonte. Nuk është çudi që intimiteti ynë dhe të qenit një u venitën, dhe nuk është çudi që rrezatimi i saj u zhduk plotësisht në këtë mjegull ngatërruese që quhej “udhëheqja ime”.

Shërbesa e Brendës ishte që të rriste fëmijë të perëndishëm. Kjo ishte thirrja e jetës së saj, dhe duke pasur parasysh dhuntinë e saj dhe thirrjen e saj të dukshme, duhej të kishte qenë e lehtë për mua që të nderoja udhëheqjen e saj në shtëpi, pavarësisht “teologjisë” që unë kisha rreth udhëheqjes mashkullore. Në fund të fundit, ishte e vetmja gjë që kishte kuptim. Siç thashë më lart, ajo kishte dalë nga një familje e krishterë prej katër brezash. Kurse unë isha produkt i një sërë familjesh jofunksionale. Ajo e dinte shumë mirë se si dukej një familje e krishterë dhe e perëndishme, ndërsa unë jo. Ajo kishte një thirrje të qartë dhe të drejtpërdrejtë nga Perëndia për të ndërtuar një të tillë. Megjithatë edhe unë e doja një të tillë, ishte e qartë që këtë do ta arrinim vetëm në

rast se unë do ta çliroja atë, që të na udhëhiqte në atë fushë. Prapëseprapë, për mua nuk ishte e lehtë dhe as nuk më vinte natyrshëm që ta lejoja atë të udhëhiqte në fushat e dhuntive të saj.

Po, përse është kaq e vështirë kjo gjë për ne burrat? Nuk është se Bibla nuk është e qartë. Për shembull, Shkrimi më urdhëron që unë ta dua Brendën ashtu si e deshi Krishti kishën. Si e deshi Krishti kishën? Me mirësi të përsosur: “Kallamin e përkulur nuk do ta thyejë dhe kandilin që bën tym nuk do ta shuajë” (Mateu 12:20). Krishti nuk i merr nëpër këmbë emocionet dhe dhuntitë tona, mirëpo, unë i shkela emocionet dhe dhuntitë e Brendës.

Bibla na nxit: “Ju burrat, duajini gratë tuaja dhe mos u bëni të hidhur ndaj tyre” (Kolozianëve 3:19). Ky urdhërim, për Perëndinë, nuk është më i vogël për nga rëndësia sesa vargu: “Mos vrit”. E megjithatë, me sa duket, unë gjithmonë e kam shpërfillur këtë varg të Shkrimit.

Gjithashtu, Shkrimi më urdhëron që ta dua Brendën në mënyrë sakrifikuese. Pra, të jap jetën time në mënyrë që më kushtojnë, për t'u siguruar që zemra dhe dhuntitë e saj të kenë hapësira në martesën tonë për të çelur edhe për të lulëzuar. (Shih Efesianëve 5:25-27).



ME PËRQASJE SAKRIFIKUESE

Bibla, pra, është e qartë me ne. Në mënyrë që ta jetoja në praktikë teologjinë e barazisë në shtëpi dhe të krijoja rrezatim në jetën e Brendës, mua më duhej që të mësoja se si t'i nënshtrohesha lehtësisht udhëheqjes së bashkëshortes sime në ato fusha të pikave të saj të forta, dhe ta sakrifikoja edhe jetën time ndonjëherë për hir të dhuntive të saj.

Shumë prej nesh kanë nevojë ta mësojnë këtë, pasi bashkëshortet e lavdishme janë të rralla. Statistikat tregojnë se 84 për qind e grave ndihen sikur nuk kanë intimitet në martesën e tyre dhe nuk janë një me bashkëshortin e tyre. Madje, një pjesë e madhe e grave të divorcuara thonë se vitet, gjatë të cilave kanë qenë të martuara, kanë qenë vitet më të vetmuara të jetës së tyre. Ka një mungesë të madhe të shkëlqimit brenda marrëdhënieve martesore, dhe për fat të keq, divorci ndonjëherë është një rrjedhojë e marrëdhënieve të thyera brenda kishës.

Çfarë ka ndodhur? A janë burrat, madje edhe ne burrat e krishterë, thjesht të pandjeshëm në zemër për nga natyra? Nuk e besoj. Unë mendoj se bashkëshortët e krishterë thjesht kanë ngelur të fiksuar me një tjetër pjesë të Shkrimit, vetëm dy vargje më përpara, tek Efesianëve 5:23, 24: "Sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti kreu i kishës dhe ai është Shpëtimtari i trupit. Ashtu si kisha i nënshtrohet Krishtit, kështu edhe gratë t'u nënshtrohen burrave të tyre në gjithçka".

Ky pasazh nuk tingëllon edhe aq shumë egalitar, apo jo? Duket sikur thotë që bashkëshortja duhet të jetë e nënshtroar ndaj një burri të plotfuqishëm e të gjithëditur, një orakulli mendjemprehtë, të cilit i janë dhënë të drejta udhëheqjeje të pakundërshtueshme. Nuk është çudi që bashkëshortët janë konfuzë në martesë! Në këtë pasazh duket sikur na thuhet se ne kemi një pozicion pak më të lartë në të gjitha marrëdhëniet me bashkëshorten tonë dhe që dhuntitë dhe mendjemprehtësia jonë duhet të jenë të spikatura e të shquara. Ndërsa në pasazhin e përmendur pak më sipër na thuhet që të japim edhe jetën tonë për hir të dhuntive dhe mendjemprehtësisë së saj, që të prodhojmë bashkëshorte të lavdishme.

Ai pasazh i ka pështjelluar për vite me radhë bashkëshortët e krishterë, të cilët pa dyshim që kanë frikë nga Perëndia, për ta rrëzuar qëndrimin e tyre egalitar në ditën e martesës. Dhe ky gabim gjendet lehtësisht si pasojë e një përkthimi të dobët kulturor të fjalës “kreu” në ditët tona. Le t’i hedhim një sy.

Sundimi mashkullor në martesë është po aq i vjetër sa vetë koha, dhe ishte veçanërisht i dukshëm në të gjithë kulturën greko-romake në kohën e Palit. Në atë shoqëri, gjërat ishin goxha të thjeshta dhe aspak të ndërlikuara. Për bashkëshortet, thjesht pritej që ato t’u bindeshin bashkëshortëve të tyre, dhe çiftet iu përmbaheshin kodeve të përcaktuara dhe të shkruara të familjes, të cilat i udhëzonin bashkëshortët rreth mënyrës si të sundonin ose të qeverisnin mbi bashkëshortet e tyre. Kështu vepronin që të gjithë.

Por Perëndia e urrente këtë gjë dhe dëshironte ta ndryshonte atë. Parimi i dhënë nga Zoti për një nënshtrim reciprok, siç shprehet tek Efesianëve 5:21, ishte një model i ri mbresëlënës, për të gjithë njerëzit në tokë, dhe ky parim është thelbi i pozicionit tonë egalitar si të krishterë: “Nënshtrojni njëri-tjetrit në frikën e Perëndisë!”.

Këto fjalë kishin për qëllim që ta çrrënjosnin sundimin tradicional mashkullor në shtëpitë tona dhe t’i sillnin marrëdhëniet martesore aty ku Perëndia ka dashur që ato të jenë që prej fillimit. Me pak fjalë, Perëndia i sfidoi bashkëshortët që të identifikohen me bashkëshortet e tyre, jo nga një pozitë pushteti dhe sundimi, por nga një pozitë dashurie, ashtu si bëri Jezusi, Biri i tij, në lidhje me nusen e tij.

Pali nuk po shkruante për të konfirmuar gjendjen aktuale të asaj kohe, por për ta përmbysur atë. Megjithatë, një pjesë e mirë e jona, ditët e sotme, janë shumë larg kuptimit të këtij mesazhi, thjesht për shkak të një çështjeje përkthimi mes dy kulturave tona. Mendojeni pak. Kur e lexojmë, vargun: “Burri është kreu i gruas” në botën tonë, për shkak se si e përkufizojmë ne sot fjalën “kreu”, na duket sikur Pali në fakt po konfirmon gjendjen aktuale të sundimit mashkullor në martesë.

Për shkak të kuptimit tonë modern të biologjisë, ne mendojmë se kreu, ose koka, është qendra qeverisëse e trupit. Në fund të fundit, pikërisht aty merren të gjitha vendimet e njerëzve. Të njëjtën fjalë e përdorim tek titujt e njerëzve si “kreu i skuadrës” ose “kreu i shtetit”, për shkak se këta udhëheqës japin vizionet që ata kanë dhe i mobilizojnë njerëzit e tyre për t’i vënë në zbatim këto vizione. Ata janë qendrat qeverisëse të organizatave të tyre. Pra, ata janë personat që thonë fjalën e fundit në gjithçka. Prandaj, kur Pali shpall se bashkëshortët duhet të jenë kreu i shtëpisë, ne supozojmë natyrshëm që bashkëshortët duhet të jenë qendrat qeverisëse të shtëpisë.

Por kjo nuk është aspak mënyra se si i lexonin efesianët fjalët e Palit. Për ta, koka nuk i referohej qendrës qeverisëse. Koka konsiderohej si burimi i jetës së trupit, dhe kjo, për një arsye shumë të thjeshtë: po e preve kokën, trupi vdes. Kur Pali shkroi se burri duhet të ishte kreu i gruas, efesianët e kuptuan menjëherë se Pali sapo ua bëri rrëmujë gjendjen aktuale të martesave të tyre. Burri i krishterë tani nuk mund të sundonte më mbi gruan e tij nga një pozitë dominuese, por përkundrazi, ta donte atë, duke qenë burimi i saj i jetës dhe një shërbëtor sakrifikues i cili sigurohej se dhuntitë e saj kishin hapësirën në shtëpinë e tyre për t’u rritur dhe për të lulëzuar.

BASHKËSHORTI SI BURIMI I JETËS

Dukshëm, fraza “burimi i jetës” bën gjithë ndryshimin, kur vjen puna për të eliminuar pështjellimin që ndodhet në rolet tona udhëheqëse si bashkëshortë. Le të shtojmë përkufizimin nga greqishtja të fjalës “kreu” tek Efesianëve 5:23-27, dhe ta shohim atë edhe një herë: “Sepse burri është [burimi i jetës] i gruas, sikurse edhe Krishti [burimi i jetës] i kishës dhe ai është Shpëtimtari i trupit. Ashtu si kisha i nënshtrohet Krishtit, kështu edhe gratë t’u nënshtrohen burrave të tyre në gjithçka. Ju, burra, duajini gratë tuaja, sikurse edhe Krishti deshi kishën dhe dha veten e tij për të, që ta shenjtërojë . . . që ta paraqesë atë përpara vetes së tij si një kishë të lavdishme . . .”.

Tani ky pasazh merr një ton komplet ndryshe, apo jo? Kuptimi i parë konfliktues mes koncepteve të “kreut” dhe “sakrificës” tani zhduket. Në këtë kontekst, dhënia e vetes për bashkëshorten është thjesht një shprehje e natyrshme dhe e domosdoshme e të qenit burimi i saj i jetës, diçka, që çdo udhëheqës që imiton Krishtin, duhet ta bëjë për të krijuar hapësirë për bashkëshorten e vet që të rritet dhe të lulëzojë në marrëdhënien e saj martesore dhe në marrëdhënien e saj me Perëndinë.

Pasi një burrë e sheh veten e tij, jo si qendra qeverisëse, por si burimi i jetës, atëherë gjithçka ndryshon në martesën e tij. Papritur, heqja dorë nga të drejtat dhe pozita ime për hir të Brendës, kishte kuptim për mua si udhëheqës. Martesa jonë u përmirësua, dhe zemra e Brendës për mua lulëzoi. Ndërkohë që unë nderoja mendimet dhe bindjet e saj, ajo ndjente se ishte një mish me mua, dhe unë nuk jam ndier kurrë më i fortë dhe më i sigurt në rolin tim si udhëheqës. Unë, qartësisht, ende isha duke udhëhequr, thjesht, tani po udhëhiqja ndryshe, dhe në mënyrë më biblike. Tani mund të hiqja dorë lehtësisht nga të drejtat e mia si udhëheqës për hir të marrëdhënies sonë dhe për hir të punës dhe qëllimeve të Perëndisë në jetën e Brendës.

TA KUPTOJMË DREJT

Sakrifica, veçanërisht sipas kuptimit që foli Pali, në të cilën unë duhet të heq dorë nga të drejtat e mia për të nderuar bindjet dhe dhuntitë e Brendës, dukej goxha më e lehtë në letër! Shumë shpejt zbulova se, krijimi i hapësirës për dhuntinë që kishte Brenda, për sa i përket dallimit familjar, nuk nënkuptonte që unë thjesht të sakrifikoja pak nga koha ime për të dëgjuar opinionin e saj rreth asaj çështjeje pa u zënë dhe pa e sharë apo qortuar atë. Ndryshe ishte të pranoja se dhuntia e dallimit në marrëdhënie që kishte Brenda, ishte më e fortë sesa dhuntia ime; dhe shumë ndryshe ishte që t'i jepja dhuntisë së saj një kontroll të vërtetë në vendimet e mia të përditshme. Kjo nënkuptonte një sakrificë të vërtetë, dhe më kushtoi vërtet shumë në marrëdhëniet e mia familjare që të lejoja mendjemprehtësinë e saj të na udhëhiqte drejt asaj lloj familjeje që të dy donim të kishim për lavdi të Perëndisë.

Zbulova shumë shpejt se ka gjëra edhe më të rëndësishme sesa ushtrimi i autoritetit tim në marrëdhënien time martesore. Pra, ju ose sakrifikoni për dhuntitë e saj siç do bënit për dhuntitë tuaja, ose nuk sakrifikoni. Në qoftë se e bëni këtë gjë, fitoni një bashkëshorte të lavdishme. Nëse jo, lavdia e saj do të venitet. Kjo është e vërtetë si për gjërat e mëdha, edhe për ato të vogla.

Për të sjellë një shembull më zbavitës, mëngjeset e të dielave u kthyen në një mishmash debatesh përgjatë viteve që i kishim fëmijët e vegjël. Për të arritur në kishë në kohë, na duhej të dilnim nga shtëpia maksimumi në orën 9:45. Mua më binte bretku duke i bërë banjë, duke ushqyer dhe duke veshur kë të më dilte përpara. Në çdo rast, unë i kisha gjërat gati për të dalë në orarin e caktuar. Por ama, Brenda nuk ishte person i mëngjesit, veçanërisht gjatë të dielave, të cilën ajo e shihte si e vetmja ditë e javës kur mund ta merrte me nge ngritjen nga krevati. Pavarësisht se sa herët e vendosnim alarmin, ora 9:45 e gjente Brendën teksa sapo kishte filluar të bënte me kaçurrela flokët e Laurës, vajzës sonë. Unë qëndroja në kuzhinë, me krahët e kryqëzuara dhe me këmbën që e tundja, duke vështruar orën dhe duke parë Brendën ndërkohë që bënte onde dhe kaçurrela. Isha aq i inatosur, sa më s'ka!

E dija se tani gjendesha në një udhëkryq: ose mund të mbroja autoritetin tim dhe të bërtisja si i çmendur, ose, të mësoja si t'i bëja flokët me kaçurrela. Gjetja e durimit të nevojshëm do të ishte një tendosje për mua, madje edhe me ndihmën e Perëndisë. Kështu që vendosa të merresha me piastrën për flokët.

Duke pasur duar të mëdha dhe grushte të fortë, e dija që nga dita e parë, që kjo gjë ishte e tepërt për

mua. Edhe Laurës, kjo marrëveshje e re, nuk i pëlqente fare, duke qenë se ia drodha flokët në mënyra të shëmtuara dhe ia dogja veshët. Bobo! Kurdoherë që ia rrumbullakosja cepat me piastrën në dorë, ajo bërtiste: “Dua që të ma bëjë mami! Dua që të ma bëjë mami!”.

Vendosa një sfidë para vetes: “Në qoftë se çdo vajzë 14 vjeçare në Amerikë mund t'i bëjë kaçurrela flokët e saj dhe ato të duken bukur, atëherë nuk ka asnjë arsye se pse nuk mund të bëjë të njëjtën gjë edhe një djalë në të tridhjetat e tij”.

Fatmirësisht, praktika të bën të përsosur. Brenda pak javëve, nën mbikëqyrjen e Brendës, e rrita nivelin e aftësisë sime deri në pikën ku mund të përmbushja standardet e saj. E dija që ia kisha dalë mbanë, një të diel të bukur, kur takova një mikun tim në hollin e kishës, i cili nga habia tha: “Sa bukur të duken flokët, moj Laura! Kushedi sa orë ka kaluar mami me flokët e tu këtë mëngjes!”.

Ajo që është më e rëndësishme, unë sakrifikova për hir të Brendës dhe udhëhoqa nga një pozicion dashurie, në vend të një pozicioni sundues apo zemërak. Tani, ditët që shkonim në kishë shkonin vaj, dhe zemra e Brendës nuk dëmtohej çdo të diel në mëngjes teksa shkonim në shërbesë.

Për të dhënë një shembull tjetër, një tjetër dhunti e fortë e Brendës është edhe mikpritja, por kur fëmijët tanë filluan të rriten, ata kishin shumë kërkesa, kërkonin kohë dhe ishin vazhdimisht të uritur. Kjo gjë krijoi një ngërç në stilin e Brendës, duke e shtrënguar shpeshherë kohën e saj të përgatitjes për mysafirët. Dhe kur, më në fund, i vinte radha shtëpisë, ishte në momentin e fundit. Tapetet duheshin fshirë me fshesë me korrent, rrugicat duheshin shkundur, pra, gjëra që ajo nuk arrinte dot t'i bënte për shkak të fëmijëve. Unë vija nga puna në shtëpi dhe e gjeja atë në panik. Shumë prej punëve të shtëpisë binin mbi shpatullat e mia gjatë përpjekjeve tona të minutës së fundit, që gjithçka të ishte “e pastër dhe në rregull” kur të arrinin mysafirët.

Kështu, si burrë që isha, nuk doja të lëshoja pe. “Pse i bën gjithë këto gjëra?”, i kërkoja shpjegim. “Është absurde! Askujt nuk i intereson në realitet për këto preket e tua të vogla, dhe askujt nuk i intereson nëse shtëpia është e përsosur. Aman! Po ata janë miqtë tanë në fund të fundit! Në rast se nuk e durojnë dot pak rrëmujë, le të shkojnë të hanë gjetiu. Ose më mirë akoma, le të gjejnë miq të tjerë!”.

Pas një prej këtyre predikimeve të mia të panumërta, me lotët që i rridhnin, Brenda më tha: “Unë nuk mund të ftoj më mysafirë në shtëpinë tonë, pa u rritur fëmijët. Në qoftë se nuk e bëj dot ashtu siç duhet, atëherë nuk dua ta bëj fare”.



Tani, kjo ishte akoma edhe më shumë çmenduri. Unë nuk e kisha me kuptimin që nuk duhet t'i kemi miqtë tanë për vizitë, për arsye se më pëlqente shoqëria. "Brenda, a po më thua se do të na privosh neve dhe fëmijët që të kemi mysafirë në shtëpi, thjesht për shkak se ti nuk bën dot gjithçka ashtu siç duhet? A nuk të duket paksa ekstreme kjo?"

"A nuk e kupton, Fredi?", më tha ajo, me sytë që më përgjroheshin. "Unë nuk pres që të ndihesh për këtë gjë njësoj si unë, por, për mua, është e rëndësishme që t'i kem gjërat në rregull. Të kemi miq në shtëpinë tonë është një shërbesë për mua".

Shërbesë? Kjo ishte hera e parë që e dëgjoja këtë fjalë të lidhej me një grup miqsh që mblidheshin të shtunave në mbrëmje për të ngrënë mish dhe perime skare. Kjo fjalë sikur më goditi mu në ballë. Brenda e shihte këtë si një shërbesë? Më në fund, fillova ta kuptoja, dhe kur e kuptova, më bëri të rishikoj mënyrën se si e kisha trajtuar gjithë këtë situatë. Zakonisht, ndërsa afrohej orari për mbërritjen e mysafirëve tanë, gjërat që bëja, ndihma me fëmijët, rregullime dhe sistemime nëpër shtëpi apo pastrime jashtë saj, unë i bëja pa qejf. Rrija me kohë të gjatë duke i bërë këto derisa dëgjoja zilen, për të hapur derën e për të pritur siç duhej miqtë tanë. Sepse në atë moment, mund të ndalej, më në fund, puna përgatitore.

KA SHËRBESË KËTU?

Kuptova që duhej të krijoja hapësirë që dhuntia e mikpritjes e Brendës të lulëzonte. Në rastet kur do të kishim miq që do na vinin në shtëpi gjatë javës, unë nisa të vija një orë më herët nga puna që të ndihmoja me gjërat rreth e rrotull shtëpisë. Gjatë fundjavave, sigurohesha që të isha në shtëpi disa orë përpara se të vinin mysafirët tanë. Mora përsipër detyrat që nuk kërkonin ndonjë aftësi të veçantë, siç është marrja e pluhurave dhe fshesa me korrent, duke i dhënë kohë Brendës për t'u marrë me prekjet e saj të veçanta. Laja tenxhere dhe tiganë ndërkohë që gjellët që po gatuheshin, kalonin nga një hap tek tjetri. Pastroja trotuarin nga bora në dimër dhe e



fshija atë në verë. Ndizja zjarrin tek soba me dru dhe rregulloja jastëkët e divanit.

Çfarë surprize! Shumë shpejt vura re se unë edhe Brenda u afruam më shumë ndërkohë që sakrifikoja me dashuri dhe e lejoja dhuntinë e saj të udhëhiqte në shtëpinë tonë, kur vinte puna tek mikpritja.

Tani, nuk është se unë jam bekuar me të njëjtat dhunti që ka edhe Brenda, apo, që tashmë papritur ndjej të njëjtën ndjenjë emergjente që e shtyn atë të bëjë të gjitha gjërat që bën. Sepse nuk është kështu. Por tani, unë thjesht e kuptova, më në fund, që ajo ka shërbesa të gjera dhe të vlefshme pikërisht në shtëpinë tonë, dhe fillova t'i nderoja ato shërbesa dhe dhuntitë e saj krah për krah dhuntive dhe shërbesave të mia.

A keni një bashkëshorte të lavdishme? Dashuria sakrifikuese prodhon bashkëshorte të lavdishme, të cilat lulëzojnë në të qenit një me bashkëshortët e tyre dhe në intimitet me ta. Premtimi është i qartë.

Përshtatur nga libri "Martesa e çdo burri" (Every Man's Marriage) nga Fred Stoeker.



FRED STOEKER, është autori më i shitur i librave seri "Çdo burrë" (Every Man).

Ai është kryetari i shërbesave Living True (Të jetojmë me çiltërsi), dhe gjithashtu folës nëpër konferenca, i cili i sfidon burrat që të jenë të pastër nga ana seksuale, dhe të rilidhen me marrëdhënie vërtet intime me bashkëshortet e tyre. Fredi është diplomuar në universitetin e Stanfordit, dhe bashkë me Brendën, bashkëshorten e tij, jetojnë në qytetin De Moi, të shtetit Ajoua.

A full-page background image showing two hikers silhouetted against a bright, sunlit sky. They are standing on a jagged, rocky mountain ridge. One hiker is lower on the rock, reaching up to help the other, who is higher up and leaning over. The sun is high in the sky, creating a strong lens flare effect. The overall mood is one of achievement and teamwork.

PËRÇJEQJËSIA E UDHËHEQËSVE SHËRBËTORË

Nga: **H. MAURICE LEDNICKY**



Termi “udhëheqës shërbëtor” bie në kundërshtim haptazi me konceptin normal, qoftë të një shërbëtori apo të një udhëheqësi. Në pamje të parë, kjo do të quhej një oksimoron, një lloj i veçantë antiteze apo një kontradiktë në terma, pra, një shprehje e cila formohet kur dy fjalë të kundërta bëhen bashkë.

Është e rëndësishme t'i kujtojmë vetes, se duke qenë fëmijë të Perëndisë, edhe pse po jetojmë përkohësisht në këtë botë (sistem), ne jemi qytetarë të mbretërisë frymërore të Perëndisë. Jezusi na mësoi se dy urdhërimet më të mëdha janë të dyja shprehje të marrëdhënieve - e para ndaj Perëndisë dhe e dyta ndaj të tjerëve. "...‘Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, dhe me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde’. Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsivetveten.’" (Mateu 22:37-39). Siç edhe do të zbulojmë në këtë pjesë, Jezusi është shembulli më i lartë i udhëheqjes prej shërbëtori, dhe qëllimi ynë duhet të jetë që ta imitojmë marrëdhënien e Tij me Atin dhe me ata të cilëve Ai iu shërbeu.

NDIQNI MODELIN E UDHËHEQJES SË KRISHTIT

Janë shkruar vëllime të panumërta që dokumentojnë me hollësi përqasjen e udhëheqjes e cila ishte e dukshme në jetën tokësore të Krishtit. Këtë nuk e them për të hapur një debat mbi vlerën e një perspektive të tillë, por vetëm për të theksuar se Ai nuk zhvilloi një stil të udhëheqjes, pra, kjo nuk ishte një sjellje e mësuar; Ai thjesht po shprehte natyrën e Tij. Prandaj duhet të kemi kujdes, që të mos e fillojmë modelin tonë me filozofinë e njeriut për udhëheqjen efikase, dhe të përfundojmë duke u përpjekur që të sinkronizojmë përfundimet tona kulturore me Shkrimin. Përpara se ta zotërojmë plotësisht praktikën e udhëheqjes prej shërbëtori, është tejet thelbësore që ne të njohim mendësinë dhe stilin personal të jetesës së shembullit tonë të përsosur.

Jezusi ishte një njeri i lutjes

Që prej kohës së pagëzimit të Tij në ujë nga Gjoni (Mateu 3:13-17), në fillimet e shërbesës së Tij publike, e deri në minutat e fundit përpara arrestimit të Tij, gjë e cila e çoi Atë shumë shpejt në kryq (Mateu 26:36-46), Bibla nënvizon faktin se Ai, Jezusi, pra, u lut. Me rastin e parë, pasi kuptoi qëllimin e plotë të misionit të Tij në këtë tokë, Zoti ynë e dinte se i duhej forca e Atit të Tij qiellor. Në kopshtin e Gjetsemanisë, duke qenë shumë i vetëdijshëm për ngjarjet që do të ndodhnin së shpejti, të cilat do t'i jepnin fund jetës së Tij, Jezusi e

dinte se i duhej forca e Atit të Tij qiellor. Modeli i Tij është goxha i qartë. Biri i Perëndisë lutej që prania e Atit të Tij t'i jepte ngushëllim dhe siguri.

Këto dy raste nuk janë në asnjë mënyrë e vetmja herë që Krishti u përkushtua ndaj lutjes. Ungjilli Sipas Lukës shpeshherë përmendet si libri ku gjendet e regjistruar një pjesë e konsiderueshme e jetës devocionale të Krishtit.

1. Gjatë kohës së pagëzimit të Tij (Luka 3:21)
2. Gjatë agjërit (lutjes) së Tij në shkretëtirë (Luka 4:2)
3. Në shkretëtirë pasi shëroi shumë njerëz (Luka 5:16)
4. Përpara se të përzgjidhte dishepujt e Tij (Luka 6:12)
5. Tek Shpërfytyrimi (Luka 9:28, 29)
6. Përpara se të jepte lutjen "Ati ynë" (Luka 11:1)
7. Për Pjetrin (Luka 22:32)
8. Në kopshtin e Gjetsemanisë (Luka 22:44)
9. Në kryq (Luka 23:46)

Përveç këtyre, Luka gjithashtu ka dokumentuar edhe tri shembëlltyra mbi lutjen.

1. Burri që e bezdisi mikun e tij në mes të natës (Luka 11:5-10)
2. Vejusha dhe gjykatësi i padrejtë (Luka 18:1-8)
3. Fariseu dhe tagrambledhësi (Luka 18:9-14)

Lutja është linja e hapur e komunikimit me Perëndinë, e cila na aftëson që të flasim lirisht, ndershmërisht dhe pa frikë. Sipas autorit të Letrës së Drejtuar Hebrenjve, inkurajimi për ne është që "t'i afrohem, pra, me guxim fronit të hirit, që të marrim mëshirë e të gjejmë hir, për të pasur ndihmë në kohën e duhur" (Hebrenjve 4:16), sepse ne nuk kemi një "kryepriest që nuk mund të vuajë bashkë me dobësitë tona, por që u tundua në të gjitha njësoj si ne, por pa mëkat" (Hebrenjve 4:15). Këto vargje kërkojnë reflektim! Krishti, i lartësuar në të djathtë të Atit, e vazhdon edhe tani shërbesën e Tij të lutjes, pra, Ai po ndërmjetëson për secilin prej nesh përpara fronit të Perëndisë.

Jezusi ishte një njeri i adhurimit të disiplinuar

Gjatë kohës së Jezusit, shtëpia e adhurimit për hebrejtë ishte sinagoga. Madje edhe në Jerusalem, ku ndodhej Tempulli, ekzistonte pothuajse 500 sinagoga.

Ndoshta do të ishte me interes pakëz informacion historik në lidhje me mënyrën sesi u themeluan në fillim këto vende të adhurimit. Përgjithësisht është rënë dakord se sinagogat e para u organizuan gjatë periudhës së robërisë në Babiloni; kohë e cila, në thelb, iu dha fund viteve të Mbretërisë së Izraelit. Ndërkohë që kjo periudhë zhvillohej, çdo komunitet apo fshat, i cili kishte të paktën dhjetë burra hebrej të kualifikuar, mund të ndërtonte një sinagogë.

Megjithëse strukturat ndryshonin goxha nga njëra-tjetra, secila prej tyre do të ishte e pajisur me një sënduk ku të mund të ruheshin Shkrimet (Ligji dhe Profetët). Mësuesit do të lexonin nga pergamenat ndërkohë që rrinin në këmbë, dhe pastaj do të qëndronin zakonisht ulur, teksa jepnin shpjegime mbi pjesën që ishte lexuar. Pjesa e përparme e ndërtesës kishte një platformë të ngritur ku qëndronin një karrige dhe një tavolinë, prej nga ku do të bëhej leximi dhe mësimi. Matanë pjesës ballore, ishin karriget ku uleshin krerët e sinagogës. Kjo ndërtesë gjithashtu përdorej si një lloj qendre komunitare ku zhvilloheshin orë mësimi për fëmijët dhe merreshin në shqyrtim çështje të tjera pune.

Sinagoga ishte qendra kryesore (vatra) për jetën në komunitet, aktivitetet e përditshme dhe adhurimin në ditën e shabatit për ata njerëz të cilët jetonin në afërsi me të. Nga ana tjetër, kemi shumë referenca për sinagogat tek ungjijtë dhe tek libri i Veprave të Apostujve; por megjithatë, këto vende të themeluara të adhurimit nuk përmenden fare në asnjë nga letrat e tjera që erdhën më pas, me përjashtim të dy rasteve tek libri i Zbulesës. Në të dyja këto raste, ndërkohë që Krishti iu adresohet shtatë kishave të Azisë së Vogël, Ai iu referohet atyre si "sinagoga të satanit" (Zbulesa 2:9; 3:9).

Shumë shpejt pas pagëzimit me ujë të Jezusit, Ai u kthye në Nazaret dhe shkoi në sinagogë gjatë ditës së shabatit "siç e kishte zakon" (Luka 4:16) dhe Atij iu dha pergamena që ta lexonte. Nga ky gjest, duke e lejuar Atë të lexonte dhe të shpjegonte pasazhin, mund të nxjerrim fare lehtë përfundimin se Jezusi njihej shumë mirë në sinagogën e qytetit të Tij dhe se kishte mirëbesimin e krerëve dhe të njerëzve që adhuronin aty.

Përgjatë tri viteve të ardhshme, ndërkohë që Jezusi udhëtonte nga një fshat në tjetrin, dhe nga një qytet në tjetrin, Ai shkoi në sinagoga për të predikuar dhe për të dhënë mësim, edhe pse nuk kishte asnjë edukim profesional në ligjin e rabinëve. Përveç kohës së Tij vetjake të lutjes dhe devocionit, Jezusi ishte i përfshirë rregullisht në adhurim të përbashkët me njerëz të tjerë.

Jezusi ishte një njeri me parime të papërkulshme

Ajo që na mëson Bibla është e qartë: Jezusi jetoi një jetë pa asnjë mëkat (2 Kor.5:21; Heb.4:15; 1 Pje.3:18). Me rëndësi është edhe fakti që Jezusi u ngjiz nga Fryma e Shenjtë dhe u lind nga virgjëresha Mari (Lk.1:26-38), gjë që do të thotë se Jezusi nuk u lind nën mallkimin e mëkatit të Adamit. Ai nuk kishte një natyrë të prishur e të shtrembëruar. Për disa teologë, përfundimi është që për arsye se Ai ka ardhur në këtë botë me një lindje të mbinatyrshme, Krishti nuk ka mëkatuar.

Ndërkohë që e dimë nga Shkrimi se Jezusi nuk mëkatoi gjatë kohës që Ai ishte në tokë, aty lexojmë gjithashtu se ai "u tundua" më shumë se një herë. Ndodhia më e detajuar për sa i përket Krishtit që tundohet nga satani, na paraqitet pasi Ai kishte kaluar dyzet ditë në shkretëtirë duke agjëruar (Mateu 4:1-11).



"Fjeta në kishë sepse unë tani po përpiqem që të bëhem më shumë si Perëndia, edhe Ai pushoi në ditën e shtatë."

Luka i shton një poshtëshënim kësaj historie: “Dhe kur djalli e mbaroi të gjithë tundimin [pra, ciklin e plotë], u largua prej tij [pra, i qëndroi larg], për një kohë”. (Luka 4:13).

Për të marrë një shembull, Jezusi tregoi shumë dhembshuri për gruan që ishte kapur në aktin e shkeljes së kurorës. Ai madje as nuk hodhi shikimin e Tij me drejtësi drejt kësaj gruaje, duke mos e bërë kështu më të madh poshtërimin publik të saj. Ai u kërrus poshtë dhe shkroi në rërë. Ai iu tha të vërtetën farisenjve hipokritë dhe mësuesve shtinjakë të ligjit fetar, të cilët po mundoheshin që ta fusnin në kurth duke përdorur vetë fjalët e Tij. Jezusi nuk e shpërfilli Ligjin e Moisiut e as nuk e la atë pas dore si diçka që nuk duhej marrë parasysh, megjithëse Ai e dinte se këta krerë hebrenj ishin shumë të arsimuar për sa i përket rregullave që ishin vendosur nga qeveria romake në lidhje me dënimin me vdekje. Roma nuk i lejonte hebrenjtë që të kryenin ekzekutime kapitale. Pikërisht kjo është edhe arsyeja pse Jezusin e çuan tek Pilati dhe tek Herodi. Ata ishin zyrtarët e caktuar nga Perandoria Romake dhe ata kishin autoritetin për të dhënë dhe zbatuar dënimin me vdekje. Jezusi i butë e dalloj shumë shpejt motivin gjykues dhe frymën që ishte tek këta krerë fetarë, të cilët e konsideronin veten të drejtë. Ishte pikërisht njolla e qëllimit dashakeqës ajo që i përdhosi në mënyrë të dukshme parimet e perëndishme. Megjithatë, kur të gjithë akuzuesit që e mbanin veten për të drejtë, ikën vjedhurazi, Jezusi as nuk e anashkaloi dhe as nuk e harroi mëkatin e saj. Mesazhi i Tij për këtë grua ishte i dyfishtë: (1) “As unë nuk të dënoj” dhe (2) “Shko dhe mos mëkato më” (Gjoni 8:11).

Mësimi për jetën: Për ata që në të ardhmen do të jenë udhëheqës shërbëtorë në mbretërinë frymërore, niveli i parë i studimit duhet të jetë Biri i Njeriut. Përpara se të mund t'i vlerësojmë me saktësi veprimet e Tij, ne duhet të shohim thellë brenda karakterit të Tij. Të parit e një shembulli të tillë të panjollë, mund të jetë diçka dërmuese për ne, dhe kjo gjë mund të na çojë që të tërhiqemi nga përpjekjet tona për ta imituar përsosmërinë e Tij. Është më se e arsyeshme që të pranojmë se ne nuk do ta arrijmë kurrë përsosmërinë absolute. Megjithatë, kuptimi i kësaj të vërtete duhet ta përforcojë edhe më shumë nevojën tonë për të ecur krah për krah Tij. Në qoftë se e fillojmë me një jetë të disiplinuar në lutje, adhurim dhe parime të themeluara mirë, duket se po shtrojmë një themel të patundur për një udhëheqje që është e pjekur nga ana frymërore. Ju si mendoni?

SHPALOSNI NJË FRYMË PËRULËSIE

Shumë kohë më parë, e pyetën një udhëheqës të nderuar të kishës që të konstatonte tri virtetet kryesore të një të krishteri. Ai u përgjigj: “Përulësia, përulësia dhe përulësia”.

Vetë përulësia nuk është, si të themi, një virtet apo mirësi e cila futet në të njëjtin nivel me të tjerat; ajo është rrënja e të gjithave, sepse vetëm ajo merr qëndrimin e duhur karshi Perëndisë dhe e lejon Perëndinë që të bëjë gjithçka.

Zoti ynë edhe na e mësoi, edhe e vuri në praktikë përulësinë. Dëgjoni disa prej fjalëve që tha Ai:

- “Unë jam midis jush porsiaj që shërben” (Luka 22:27).
- “Mësoni nga unë, sepse jam zemërbutë dhe i përulur nga zemra . . .” (Mateu 11:29).
- “Kush të dojë të bëhet i madh ndër ju le të jetë shërbënjësi juaj; edhe kush të dojë të jetë i parë ndër ju, le të jetë shërbëtori juaj. Ashtu si Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbehet, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e Tij si shpërblësë për shumë veta” (Mateu 20:26-28).
- “Në qoftë se unë, pra, Zoti dhe Mësuesi, ju lava këmbët juve, edhe ju duhet t'ia lani këmbët njëri-tjetrit. Sepse ju dhashë shembullin që ashtu siç ju kam bërë unë juve, të bëni edhe ju” (Gjoni 13:14,15).

Ungjilli Sipas Gjonit dokumenton në mënyrë unike marrëdhënien e afërt mes Krishtit dhe Atit. Në këtë ungjill, Jezusi e quan Perëndinë Atin e tij përafërsisht





HIRI I PËRULËSISË

1. Mos mendoni për veten tuaj se jeni më të mirë për shkak të ndonjë rrethane të jashtme që ju ka ndodhur.
2. Përulësia nuk përbëhet nga kritikrat ndaj vetvetes, apo nga veshja e rrobave të vjetruara apo nga sjellja me nënshtrim kudo që shkojmë. Përulësia përbëhet nga një mendim realist për veten, që do të thotë se ti je një person i padenjë.
3. Kur keni këtë lloj mendimi për veten, jini të kënaqur që edhe të tjerët mendojnë po kështu për ju.
4. Ushqeni një dashuri për t'i bërë gjërat e mira në fshehtësi, dhe si rrjedhojë, për shkak të tyre të mos jeni edhe aq të respektuar. Jini të kënaqur të mos merrni lëvdata.
5. Mos thoni asnjëherë diçka, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, e cila nxit lëvdata apo nxjerr komplimente nga të tjerët.
6. Kur ju lavdërojnë për diçka që keni bërë, priteni me shpërfillje dhe jepjani atë lavdërim Perëndisë.
7. Krijoni një reputacion të mirë për veten tuaj duke qenë një person me virtyte dhe përulësi.
8. Mos jini krenar për asnjë nga lëvdatat që ju jepen. Gëzohuni në Perëndinë që ju jep dhunti, të cilat të tjerët mund t'i shohin tek ju.
9. Mos iu kërkonit të tjerëve që t'ju vënë në dukje gabimet tuaja me qëllimin apo synimin që ata persona të fillojnë t'ju tregojnë për cilësitë e mira që keni.
10. Kur ju shpërfill dikush, ose kur ndiheni të nënvlerësuar, mos ruani brenda jush zemërim të fshehtë. Mos kërkonit një grup lajkatarësh që do të mbajnë anën tuaj.
11. Mos ia bëni qejfin asnjëres prej pëshpëritjeve të krenarisë nga djalli.
12. Merrni pjesë aktivisht në lëvdimin e të tjerëve.
13. Jini të kënaqur kur shikoni ose dëgjoni se të tjerët po ecin mirë në shërbesat e tyre dhe me të ardhurat e tyre, edhe atëherë kur ju vetë nuk po ecni edhe aq mirë në këto fusha.
14. Mos e krahasoni asnjëherë veten tuaj me të tjerët, përveçse në rastet kur kjo gjë bëhet për të rritur përshtypjen që ju keni për ta dhe për të ulur përshtypjen që keni për veten.
15. Mos u përpiqni vazhdimisht që t'i justifikoni të gjitha gabimet tuaja. Virtyti e ka neveri gënjeshtrën për maskimin e saj.
16. Jini falënderues ndaj Perëndisë për çdo papërsosmëri që keni. Pranojeni atë si një favor nga Perëndia, një mjet për t'i rezistuar krenarisë dhe për t'i shërbyer përulësisë.
17. Mos i nxirrni në pah dobësitë e tjerëve me qëllimin që t'i bëni të ndihen më pak të aftë sesa ju.
18. Mbani mend se ajo që është e rëndësishme për Perëndinë është që t'ia nënshtrojmë Atij veten tonë dhe gjithçka që kemi.

Nga: **JEREMY TAYLOR (1613 - 1667)**

Marrë nga libri "Rregullat dhe Ushtrimet e Jetesës së Shenjtë"

[The Rules and Exercises of Holy Living]

**Kohë më parë,
e pyetën një
udhëheqës të
nderuar të kishës
që të konstatonte
tri virtytet kryesore
të një të krishteri.
Ai u përgjigj:
“Përlësia, përlësia
dhe përlësia”.**

100 herë, gjë që thekson se Krishti është Biri i Perëndisë. Në pasazhet që janë nxjerrë më poshtë, vini re se sa shpesh i përdor Krishti fjalët “asgjë” dhe “nuk” duke iu referuar përlësisë që Ai ka përpara Atit të Tij.

- “Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetes” (Gjoni 5:19).
- “Unë s’mund të bëj asgjë nga Vetja Imë; gjykoj sipas asaj që dëgjoj dhe gjyqi Im është i drejtë, sepse nuk kërkoj vullnetin Tim” (Gjoni 5:30).
- “Unë nuk marr lavdi nga njerëzit” (Gjoni 5:41).
- “Sepse Unë kam zbritur prej qiellit jo për të bërë vullnetin Tim” (Gjoni 6:38).
- “Doktrina Imë nuk është e Imja” (Gjoni 7:16).
- “Unë s’kam ardhur nga Vetja” (Gjoni 7:28).
- “Nuk bëj asgjë prej Vetvetes” (Gjoni 8:28).
- “Unë nuk kërkoj lavdinë Time” (Gjoni 8:50).
- “Fjalët që po ju them, nuk i them nga Vetja” (Gjoni 14:10).
- “Fjala që po dëgjoni nuk është Imja” (Gjoni 14:24).

Shpeshherë është thënë se sapo ta dallojmë përlësinë tonë, atëherë e kemi humbur atë. Përlësia e vërtetë nuk është kur shajmë apo qortojmë veten tonë, duke u sjellë vërdallë kokulur dhe duke folur me një zë që mezi dëgjohej, “si miza në qyp”. Përlësia e vërtetë vjen përmes njohjes së pozicionit tim në Krishtin. “Me anë të hirit të Perëndisë jam ai që jam . . .” (1 Korintasve 15:10).

Në rast se dua t’i udhëheq të tjerët drejt përjetimit të shpëtimit, me anë të hirit të Perëndisë përmes besimit të Krishti, atëherë më duhet të kuptoj se unë jam veçse një kanal përmes të cilit dërgohet dhe shpërndahet Fjala. “Kini në veten tuaj po atë mendje që ishte edhe në Jezu Krishtin, i Cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazi Vetën e Tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përluli Vetën duke u bërë i bindur deri në vdekje, edhe deri në vdekje të kryqit” (Filipianëve 2:5-8).

Mësimi për jetën: Hiri i përlësisë është i vështirë për t’u kategorizuar dhe shumë i pakapshëm për t’u arritur dhe për t’u mbajtur. Fryma e përlësisë nuk dallohet nga personi që e ka atë. Ndoshta pikënisja më e mirë do të ishte që me fillimin e çdo dite të përlëshim me nënshtrim, dhe me mirënjohje të thellë, ndaj Atij që na ka zgjedhur të jemi shërbëtorët e Tij. Të jetosh një jetë me përlësi kërkon zell të vazhdueshëm, pasi shpeshherë hasim ose lavdërime, ose ofendime. Plani më efikas, për çdo situatë, është që t’i lejojmë të tjerët të shohin Krishtin që jeton brenda nesh dhe përmes nesh.

Zoti dhe shpëtimtari ynë modeloi për ne tri cilësi shumë të rëndësishme: (1) Ai ishte një njeri i lutjes, (2) ishte i disiplinuar në adhurim, dhe (3) ishte i papërkulshëm në parimet e Tij. Dhe fryma e përlësisë ishte për këtotribute të argjendta në mbulesë, e cila i mbështillte ato. Këto karakteristika themelore duhet të ushqehen në mënyrë të qëllimshme në jetët tona. Nuk do të ngriheni një mëngjes nga gjumi dhe papritur të zbuloni se tani i keni adoptuar personalisht prioritetet e Tij. Por, duke ecur me hirin e Perëndisë, ditë pas dite, duke jetuar të mbushur nga Fryma një jetë në bindje ndaj Fjalës së Tij, ne mund të rritemi dhe të arrijmë pjekurinë në Krishtin (2 Korintasve 3:18; Efesianëve 4:14-16). Pavarësisht nga fjala e mëposhtme që mund të zgjidhni, në të vërtetë ne duhet të bëhemi ambasadorët, përfaqësuesit, zëdhënësit, dishepujt, ndjekësit dhe shërbëtorët e Tij, në Kishën e Tij, për Kishën e Tij, si edhe për botën tonë.



Dr. H. MAURICE LEDNICKÝ,
shërbyes i shuguruar me
Asambletë të Perëndisë për 50 vjet.
Ai është autor, ungjilltar, pastor,
misionar, dhe ish-president i
shkollës Central Bible College,
Springfield, Missouri.



Nga: ROBERT C. CROSBY

UDHEHEQJE VENDIMTARE:

*Një matricë biblíke
për të gjetur urtësi*

Si pastorë dhe ndjekës të Krishtit, si mundemi ne që ta njohim rrugën e urtësisë? Në rastet kur Bibla nuk na jep një përgjigje të qartë, si mund të jemi ne të qartë? Më poshtë gjeni shtatë karakteristika dalluese për një vendim të urtë.

A e keni vënë re se jeta dhe shërbesa pastorale janë të mbushura me situata dhe konflikte të cilat Bibla i adreson në mënyrë specifike, ndërsa disa të tjera thjesht nuk i adreson? Se, në fund të fundit, ku është ai pasazhi që më tregon se ç'lloj tapeti na duhet për ta vendosur në korridorin e kishës dhe sa para duhet të shpenzojmë për të? Cili varg do të më udhëzojë mua dhe bashkëshorten time nëse për pushimet e ardhshme duhet të ikim ne të dy vetëm si çift, apo së bashku me disa miq? Cili pasazh më zbulon se sa kohë duhet t'i përkushtoj çdo javë studimit dhe lutjes, dhe sa kohë pushimit dhe argëtimit?

Në Izraelin e lashtë, ndërkohë që njerëzit përballe- shin me vendime dhe dilema morale, për të cilat Torah (apo Dhjata e Vjetër) nuk ishte e detajuar, udhëheqësit fetarë i shtuan Ligjit duke shkruar kërkesa të hollësishme në Talmud (që është një listë e gjatë rregullash shtesë e të pavend jashtëbiblike). Këto u kthyen në barra jashtëzakonisht të rënda.

Jezusi i akuzoi krerët fetarë se ishin “udhëheqës të verbër”, të cilët “sitin mushkonjën dhe kapërdijnë devenë” (Mat 23:24). Këta krerë fetarë fokusoheshin në degët dytësore të jetës. Dhe duke bërë kështu, Jezusi tha se, kishin lënë pas dore “gjërat më të rëndësishme të ligjit: gjyqin, dhe mëshirën dhe besimin” (vargu 23). Ndërkohë që këta udhëheqës i kishin kthyer bindjet e tyre personale në rregulla pritshmërie të cilat ishin mbytëse për të tjerët, ata po humbnin rëndësinë e vendimarrjes të shtyrë nga vlerat, si dhe shtegun e urtësisë.

MË MIRË SE RREGULLAT

Ajo lloj udhëheqjeje e cila e nderon Perëndinë, kërkon më shumë sesa thjesht një përmbledhje të hollësishme rregullash. Vendimet më të mira të udhëheqjes janë gjithashtu edhe vendimet më të urta. Pra, në fund, ne kemi rregulla për shkak se shumë shpesh nuk kemi urtësi.

Le të reflektojmë pak për këtë. Nga burojnë parimet dhe udhëzimet e Perëndisë? Ato rrjedhin nga karakteri i tij. Me fjalë të tjera, Perëndia nuk ka nevojë për rregulla që të funksionojë, sepse ai ka diçka më të mirë. Ai ka karakter të përsosur dhe, rrjedhimisht, urtësi të përsosur. Vendimet e tij rrjedhin nga qenia e tij, se kush është Ai. Duke qenë se ai, në thelbin e natyrës së vet, mbart cilësinë e urtësisë së pastër, atëherë nuk i duhen motivimet jothelbësore të rregullave dhe pasojave.

Por, si pastorë dhe ndjekës të Krishtit, nga ta njohim ne rrugën e urtësisë, veçanërisht gjatë atyre vendimeve të sekondës së fundit, apo vendimeve 180 gradësh të jetës dhe shërbesës? Në ato raste kur Bibla nuk na jep një përgjigje të qartë, si mund të jemi ne të qartë?



DY LLOJ URTËSISH

Kur Jakobi shkroi letrën e tij që është pjesë e Dhjatës së Re, ai dëshironte t'i ndihmonte lexuesit që të kuptonin se si t'i manovronin jetët e tyre me urtësi të perëndishme në mes të rrugëve moralisht të rrëshqitshme të kulturës romake.

Tek Jakobi 1:5, ai shkruan:

“Por në qoftë se ndonjërit nga ju i

mungon urtësia, le të kërkojë nga

Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim,

pa qortuar, edhe atij do t'i jepet”.

“Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtësia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, edhe atij do t'i jepet”.

Lajmi i mirë është që ne kemi një instruktor, pikërisht përkrah nesh, ndërsa japim provimin praktik të jetës, dhe ai nuk do të hezitojë që t'u përgjigjet kërkesave tona për urtësi.

Jakobi vazhdon duke paralajmëruar se nuk ka vetëm një lloj urtësie. Ekziston një urtësi tokësore dhe një urtësi qiellore, pra, urtësi “që vjen nga poshtë” dhe urtësi “që zbret nga lart”.

“Por urtësia që vjen nga lart, më së pari është e pastër, pastaj paqësore, e butë, e bindur, plot mëshirë dhe fryte të mira, e paanshme dhe jo hipokrite. Por fryti i drejtësisë mbillet në paqe për ata që bëjnë paqen” (Jakobi 3:17, 18).

Me formën e tij praktike, që e karakterizon, Jakobi po mban në dorë grafitë e dy zemrave të ndryshme, pra, dy lloje urtësish që janë në kontrast me njëra-tjetrën. Ai na zbulon se urtësia e perëndishme nuk është thjesht një bashkësi rregullash rrugore për të udhëhequr zgjedhjet që bëjmë; por është ajo lloj zemre që Perëndia dëshiron të rritet brenda nesh.

Ndërkohë që i shohim këto dy zemra të vendosura në sfondin e dritës së të vërtetës së Perëndisë, shohim që dalin disa tema kyçe rreth natyrës së urtësisë. Këto karakteristika formojnë disa pika kontrolli, përmes të cilave mund t'i inspektojmë vendimet tona në rast se duam që me të vërtetë të sigurohemi se vendimet tona të udhëheqjes janë të urta. Mund të themi që Jakobi na jep një matricë vendimi për urtësinë.

Ndërkohë që i lexoni këto pika për inspektim, merrni parasysh një vendim me të cilin po përballeni aktualisht, i cili është veçanërisht sfidues, ose një

vendim me të cilin jeni përballur kohët e fundit. Shikojeni këtë vendim duke e mbajtur nën këqyrjen e kujdesshme të Shkrimit.

SHTATË KARAKTERISTIKAT E URTËSISË

1. Një vendim i urtë është i pastër. Sansoni ishte një udhëheqës i Dhjatës së Vjetër, i cili iu shmang pikës së kontrollit për pastërtinë gjatë procesit të vendimmarrjes. Megjithëse e filloi me kaq shumë gjëra: vinte nga një familje të perëndishme, pati favorin e Perëndisë, kishte forcë të jashtëzakonshme dhe përkrahjen e njerëzve rreth e rrotull tij, ai mori një sërë vendimesh të cilat ia garantuan dështimin moral. Le të marrim në shqyrtim disa prej tyre. Së pari, ai vendosi që të ishte një vetmitar, një njeri i tërhequr, duke e ndarë veten nga kështilla e perëndishme që mund të merrte (Fjalët e Urta 11:14). Pastaj, në mënyrë të rrezikshme dhe të pamatur, ai hyri në territorin armik (Gjyqtarëve 14:3). Për fatin e tij të keq, ai e shpërfilli, ose e nënvlerësoi, thirrjen e Perëndisë për jetën e tij, duke preferuar që në vend të kësaj të ndiqte kënaqësitë personale. Dhe, duke mos mësuar nga gabimet e të kaluarës, ai sillej si i pamend, duke shkuar nga marrëzia e një marrëdhënieje të gabuar tek tjetra (Gjyqtarët 16:1–4).

Në asnjë moment në historinë e treguar në Bibël nuk e shohim këtë udhëheqës që të bëjë pyetjen: “A është e pastër kjo gjë? A është ajo e pajtueshme me kodin moral të Perëndisë? A mund ta ndjek atë me një ndërgjegje të pastër?”.

Përfundimisht, Sansoni, duke dështuar që të merrte vendime me pastërtinë e mendjes, solli shkatërrim mbi veten e tij.

2. Një vendim i urtë është paqësor. Disa vite më parë, e kapa veten teksa isha i mërzhitur me një nga besimtarët e kishës. Ai kishte bërë disa komente të pasjellshme dhe goxha lënduese karshi disa mysafirëve që kishin ardhur për vizitë. Pasi e kishim lënë që të takoheshim një pasdite për të diskutuar situatën e përshkallëzuar, unë qëllimisht arrita tek vendi i takimit një orë më herët. E dija që kjo bisedë me të ishte e drejtë, ndoshta edhe e urtë, por gjithashtu e dija edhe që mënyra si ndihesha unë rreth kësaj situatë ishte e gabuar.

Për vite me radhë, kisha parë të krishterë që kishin abuzuar me këshillën biblike për ta “thënë të vërtetën me dashuri” (Efesianëve 4:15), duke ofruar thjesht ndonjë koment parandalues apo neutralizues, të tipit: “I dashur vëlla (e dashur motër), të kam shumë xhan, por...” dhe pastaj, me fjalë, sa nuk i kishin pushkatuar ata. Kisha frikë, mos edhe unë do të bëja të njëjtën gjë.

Ndërkohë që lutesha, ndjeva Zotin teksa më inkurajonte të bëja thjesht atë që thoshte vargu, pra, që të flisja duke e thënë të vërtetën me dashuri. Duhej të isha plotësisht i sinqertë me këtë vëlla, por këtë duhej ta bëja me dashuri. Nuk do të kishte dobi për askënd bërtitja apo të qenit i zemëruar (Jakobi 1:20), por të qenit i sinqertë dhe i dashur mund të sillte shumë të mira.

Dhe pavarësisht habitës sime, kjo gjë funksionoi. Me ndihmën e Perëndisë, i tregova këtij djali se sa lënduese kishin qenë fjalët dhe veprimet e tij. Ai kërkoi falje. Ne u lutëm dhe e hodhëm pas këtë incident. Ky veprim e çarmatosi emocionalisht konfliktin. Atë ditë, unë përjetova të vërtetën që në qoftë se një vendim është me të vërtetë i urtë, ai është gjithashtu edhe paqësor.

3. Një vendim i urtë është i butë (i merr në konsideratë edhe personat e tjerë). Pali na udhëzoi që t'i vendosnim interesat e të tjerëve përpara interesave tona (Filipianëve 2:4). Si udhëheqës që jetojmë në një botë ku çdo njeri shikon interesat e veta, dhe jo ato të të tjerëve, cilësia e të qenit i butë ose i vëmendshëm ndaj të tjerëve, ndrin mes errësirës. Kjo cilësi është një xhevahir i rrallë, por gjithashtu edhe një pikë jetike inspektimi për të përcaktuar urtësinë, apo mungesën e saj, në vendimet tona. Vendimet e urta i marrin në konsideratë njerëzit e tjerë të cilët janë të përfshirë në atë rrethanë, duke futur këtu perspektivat e tyre, atë që vjen si rrjedhojë për ta në atë çështje, si edhe ndjenjat e tyre rreth saj.

4. Një vendim i urtë është i bindur. Ne marrim vendime të urta duke pasur një ndjenjë përlusie. Vendimet e urta nuk i lënë mënjatë e as nuk i harrojnë rolet tona si udhëheqës, e gjithashtu edhe figurat e autoritetit mbi të cilat vendimet tona kanë ndikim. Jakobi u kujton lexuesve të "përmbushni ligjin mbretëror sipas Shkrimit: 'Duaje të afërmin tënd si vetveten'" (Jakobi 2:8). Ndërkohë që Skot McKnight (Scot McKnight), një studiues i Dhjatës së Re, e quan këtë varg "Kredoja e Jezusit", Jakobi thjesht e quan urtësi. A është me të vërtetë vendimi juaj i bindur (i nënshtruar) ndaj të tjerëve?

5. Një vendim i urtë është plot mëshirë dhe frytë të mira. Njëherë, u përballa me një vendim sfidues mu në mes të shërbesës së Darkës së Zotit. Siç ishim të mbledhur me një grup udhëheqësish nga kisha, drejtuesi i atij takimi na udhëzoi të zgjidhnim një person me të cilin të ndanim Darkën e Zotit. Ndërkohë që po e mendoja, e kisha të qartë menjëherë se kush ishte personi të cilin Perëndia dëshironte që unë ta pyesja për këtë gjë. Nuk ishte një shok i ngushtë apo dikush që po qëndronte afër

meje. Në fakt, ishte një udhëheqës me të cilin kisha pasur një mosmarrëveshje të fortë disa vite më parë. Megjithatë kishim bërë disa përpjekje për ta zgjidhur konfliktin, akoma kishte mbetur një rrënjë e hidhur.

Në mendjen time ishte formuar një listë e gjatë me arsye se përse unë nuk doja ta bëja këtë hap. Në fund të fundit, kishte qenë ai që ishte zemëruar, jo unë. A nuk duhej ta merrte ai hapin i pari? Duke qenë edhe më i vjetër se unë, a nuk duhej ta merrte ai iniciativën? Por në zemrën time, Fryma e Shenjtë po formonte listën e vet.

Ato hapa, atë ditë, nga njëra anë e dhomës tek tjetra, ishin një nga rrugëtimet më të vështira që kam bërë ndonjëherë. Por ishte e qartë se ishte vendimi i duhur, ai i urti. Çdo vendim tjetër nuk do të kishte qenë plot mëshirë dhe frytë të mira.

Ndërkohë që unë dhe ai vëlla po ndanim Darkën e Zotit, me simbolet solemne të trupit dhe të gjakut të Zotit tonë Jezu Krisht, ndjemë që Perëndia ishte i pranishëm, në mënyrë të fuqishme. Tensionet që kishim ndërë u shkrinë, hiri u shfaq dhe ne ndërtuam një urë. Mëshira e udhëhoqi rrugën atë ditë, teksa unë mora vendimin tim, një vendim të urtë.

6. Një vendim i urtë është i paanshëm. Në disa mënyra, kjo pikë mund t'i përngjajë pikës që përmendëm më lart, e cila bënte fjalë për të qenit i vëmendshëm ndaj të tjerëve. Megjithatë, edhe pse është e rëndësishme që ta shikoni çështjen duke u vendosur në pozitën e atyre personave që janë të përfshirë në vendimet tuaja, kjo pikë inspektimi e urtësisë është diçka tjetër, diçka më shumë. Këshilla e Jakobit për paanshmëri në vendimmarrje, u shton veprimeve tona të buta një ndjenjë të barazisë në drejtësi.



PIKAT E KONTROLLIT TË URTËSISË

Shtatë pyetje biblike për të përcaktuar nëse alternativa juaj e udhëheqjes është një zgjedhje e urtë

(Bazuar mbi vargjet tek Jakobi 3:13-18)

1. A është i pastër ky vendim? Në qoftë se e bëj këtë, a do të jem duke bërë, në ndonjë mënyrë, kompromis me integritetin dhe karakterin tim? A mund ta bëj me një ndërgjegje të pastër?
2. A është paqësor ai? A do t'i forcojë ky vendim marrëdhëniet e mia apo do t'i dobësojë ato?
3. A është i butë ky vendim; pra, a i merr në konsideratë dhe a tregohet i butë me personat e tjerë? Me këtë zgjedhje, a po mendoj për të tjerët apo thjesht për veten time?
4. A është i bindur vendimi? A do ta miratojnë këtë vendim udhëheqësit e perëndishëm që njoh?
5. A është plot me mëshirë dhe fryte të mira ai? A reflekton ky vendim Krishtin dhe hirin e Tij për të tjerët?
6. A është i paanshëm? A po tregohem vërtet i drejtë me njerëzit që do të preken nga ky vendim?
7. A është i singertë (jo hipokrit) ky vendim? A po tregohem i çiltër me Perëndinë dhe me bindjet e mia? A e kam kërkuar të vërtetën dhe a e kam ngritur vendimin tim mbi atë të vërtetë? A është ky një hap drejt integritetit?

Përshtatur nga artikulli

Decisions, Decisions ["Vendime, Vendime"]

*nga: **Robert C. Crosby***

Ky artikull u botua fillimisht në

Discipleship Journal [Gazeta e Dishepullizimit].

Duhet ta pranojmë këtë gjë. Një tundim i madh me të cilin përballen pastorët dhe udhëheqësit, është tundimi për të favorizuar dikë e për të pasur anshmëri në një çështje të caktuar. Shpeshherë është kaq kollaj që t'u japim avantazhe të padrejta njerëzve të cilët janë në rrethin tonë, atyre që na krehin bishtin, familjeve dhe kontakteve, duke mos u bazuar tek meritat dhe tek karakteri i tyre, por, përkundrazi, duke u bazuar tek gjëra të tilla si nepotizmi dhe tarafilëku (mbajtja me hatër e familjarëve apo e miqve). Edhe pse vendime të tilla e rrisin më shumë ndjenjën e rehatisë për ne si udhëheqës, me shumë gjasa që ato i vënë në pozita shumë të vështira e të parehatshme njerëzit të cilëve ne iu shërbejmë. Vendimet e urta janë vendime të paanshme.

7. Një vendim i urtë është i singertë (pa hipokrizi). Vendimet më të mira që marrim nuk rrjedhin thjesht nga avantazhi strategjik; ato vijnë nga vlerat dhe nga bindjet tona. Vendimet e urta burojnë nga një vend i thellë brenda shpirtit tanë, pra, nga Perëndia, nga Fjala e Tij dhe nga vlerat e mbretërisë së Tij. Ne nuk i "veshim" zgjedhjet e urta për nevojën urgjente apo për avantazhin tonë personal.

Përkundrazi, ne i nxjerrim ato nga një përbashkësi (miqësi) e qëndrueshme me Perëndinë dhe nga mendimet dalluese të cilat vijnë si rezultat i kësaj përbashkësie. Ato vijnë nga një vend i vërtetë brenda nesh. Vendimet e urta janë vendime të ndershme përpara Perëndisë.

MARRJA E PROVIMIT

Një ditë bëra provimin e makinës për të marrë patentën. Pasi e mbarova provimin praktik, hapa krahun dhe ndërkohë që isha ende në makinë, po prisja vendimin e komisionit.

Instruktori kryesor më tha: "Më vjen keq, djalosh, por nuk e kaluat provimin. Në vend që t'i bënit shenjë makinës pas jush që t'ju parakalonte, ndërkohë që po ktheheshit në vend, ju thjesht vazhduat të ktheheni, ndërkohë që makina pas jush priste dhe po ju shihte juve. Në atë situatë, gjëja më e rëndësishme për ju duhej të ishte siguria e të gjithë pasagjerëve të përfshirë. Paç më shumë fat herën tjetër".

Instruktori kishte një parim themelor, të fiksuar mirë në mendjen e tij, të cilin nuk e gjeja dot në manualin e shoferit. Ndërkohë që isha përqendruar të mbaja mend vetëm rregullat e

shkruara, instruktori ishte edhe më i shqetësuar rreth vlerave të brendshme që kishin nxitur vendimin tim.

Pas një muaji, dhe pak më i urtë në shpirt, më në fund e mora provimin e patentës. Në analizën përfundimtare, urtësia për të cilën kisha nevojë atë ditë nuk gjendej në manualin e shoferit, por diku tjetër. Në këtë rast, nuk ishte tek një fjalë, por tek një vlerë.

Jakobi na paralajmëron se jeta dhe udhëheqja do të përfshijë shumë provime praktike.

“Ta quani gëzim të madh, o vëllezër të mi, kur bini në tundime të ndryshme, duke e ditur se sprova e besimit tuaj sjell durim” (Jakobi 1:2,3).

Bëhuni gati. Një tjetër sprovë (a provim) po ju pret tek cepi i rrugës. Por këtë herë, juve dini diçka shumë herë më të mirë se rregullat; tani ju dini karakteristikat e një vendimi të urtë.



ROBERT C. CROSBY, është një shkrimtar, folës konferencash dhe një profesor i teologjisë praktike në universitetin “Juglindor” në Lejklend, Florida. Ai ka shërbyer për mbi 25 vjet si pastor. Disa nga titujt e librave të tij janë: “Ai që Jezusi e do” (*The One Jesus Loves*, Thomas Nelson), “Kisha që grupohet: Shërbesa në epokën e bashkëpunimit” (*The Teaming Church: Ministry in the Age of Collaboration*) dhe “Gjëra për të filluar bisedën” (*Conversation Starters*).

V
**Vendimet më të
mira që marrim nuk
rrjedhin thjesht nga
avantazhi strategjik;
ato vijnë nga vlerat
dhe nga bindjet
tona. Vendimet e
urta burojnë nga një
vend i thellë brenda
shpirtrave tanë,
pra, nga Perëndia,
nga Fjala e Tij dhe
nga vlerat e
mbretërisë së Tij.**

GJIGANDËT

në mesin tonë

Nga: JEFF DOVE



Uke qenë se kam shërbyer në shërbesë me kohë të plotë për gati dyzet vjet si pastor i një kishë vendore, si misionar në Azi dhe tani, si drejtori i një shërbese mbarë-botërore e cila iu vjen në ndihmë udhëheqësve me burime të ndryshme, unë kam pasur mundësinë që të shoh se si funksionon në të vërtetë shërbesa e kishës vendore... se çfarë i bën ingranazhet të rrotullohen dhe çfarë e rrit efikasitetin e kishës.

Ata që dalin në skenë apo që kanë tituj dhe pozicione drejtimi shpeshherë lakohen, vihen në dukje dhe marrin meritat për punën. Dhe lavdi Perëndisë për shërbenjësit me kohë të plotë, të cilët i janë dhënë trupit të Krishtit si një dhuratë!

Megjithatë, shumë shpesh janë pikërisht ata që shërbejnë me besnikëri në prapaskenë, në pozicione shërbimi dhe shërbese "të cilat nuk vihen në dukje", personat që e mbajnë efikasitetin e kishës në stadet më të fundit të zhvillimit. Këta janë njerëzit tek të cilët mund të mbështeteni gjithmonë, ata që shërbejnë jashtë ndriçimit të prozhektorëve, dhe prapëseprapë, në stinën e duhur, ata do të marrin shpërblimin e një shërbëtori besnik.

Disa shembuj të këtyre personave nga Shkrimi janë si më poshtë:

- **Historia e Abdias tek 1 Mbretërve 18.** Abdia shërbeu me besnikëri dhe qëndrue-shmëri, edhe pse ai nuk ishte nën dritën e prozhektorit, dhe ajo që bënte, duhej të mbahej e fshehtë. Në një kohë kur shumë njerëz kishin hequr dorë nga besimi, dhe udhëheqësi i popullit po përndiqte në fakt shërbëtorët e Perëndisë, Abdia rrezikoi pozitën, financat e tij, dhe madje edhe jetën e vet për të shërbyer në prapaskenë si një ruajtës i këtyre profetëve të Zotit.
 - **Një tjetër shembull nga Shkrimi është edhe ai i Aaronit dhe Hurit dhe se si ata i mbajtën lart krahët e Moisiut, profetit të Perëndisë, tek Eksodi 17.** Në kuptimin e plotë të fjalës, ata ishin po aq përgjegjës për fitoren kundër amalekitëve, sa edhe Moisiu. Ata shërbyen në një pozicion jo shumë joshës, por gjithashtu në një pozicion që ishte jetik për suksesin e kësaj përpjekjeje. Ata iu ngjitën kodrës për të qenë me Moisiun dhe për të parë shtrirjen e konfliktit. Ata ishin në gjendje të siguronin atë që nevojitej, në atë kohë, për të përmbushur detyrën që Zoti i kishte dhënë Moisiut. Moisiu mbante shkopin e Perëndisë, por ata mbajtën krahët e atij që mbante shkopin.
 - **Përsëri, tek Eksodi 36, Betsaleeli dhe Oholiabi** e kishin kuptuar se Moisiu kishte marrë një vizion, një drejtim dhe plane nga Zoti. Kur Moisiu i ndau këto plane me ta, ata e pranuan vizionin dhe ofruan kohën, talentin dhe energjinë e tyre të konsiderueshme për të ngritur tabernakullin në shkretëtirë. Me zemrat, duart dhe mendjet e tyre, ata mbështetën dhe prodhuan punën e Mbretërisë. **Ata ishin gjigantë në mesin tonë.**
- Në vetë jetën time, mund të më kujtohen kaq shumë burra, të cilët kanë shërbyer me besnikëri dhe në mënyrë të dalluar, jashtëzakonisht të besueshëm dhe të besës, duke shërbyer njësoj sikur të ishin duke e bërë këtë gjë për vetë Shpëtimtarin.
- **Një burrë me emrin Pol,** hapte dyert e kishës përpara se të vinin njerëzit dhe qëndronte derisa të ishte ai i fundit për ta kyçur kishën. Këtë gjë, ai e bëri për dekada me radhë, me besnikëri dhe pa e neglizhuar. **Ai ishte një gjigant në mesin tonë.**
 - **Një burrë me emrin Denzel,** përgatiste mesazhet, për vite e vite radhazi, dhe ilustronte historitë për fëmijët e moshës 8-11 vjeç. Historitë dhe ilustrimet e tij vazhdojnë që të jenë ende të gjalla tek unë edhe pse kanë kaluar më shumë se 50 vite jetë. Ai më mësoi ta doja historinë e Shkrimit. **Ai ishte një gjigant në mesin tonë.**

➤ **Një burrë me emrin Çarli:** Në vitin 1982, unë qëndroja në ballë të një shenjtëroreje tepër të përlur, e cila nuk mbante më shumë se 50 njerëz, në rast se të gjitha karriget do të ishin të zëna mëngjeseve të së dielës. Pikërisht aty, gjatë lavdërimit dhe adhurimit, pas shërbesës së Fjalës, unë përjetova një vegim nga Zoti. Nuk kam marr shpesh vegime apo manifestime të tjera fizike apo frymërore të kësaj natyre, por atë natë, perdet e së ardhmes u hapën para meje. Aty pashë ndërtesën e kishës të cilën Zoti dëshironte që ne të ndërtonim për të akomoduar bashkësinë tonë, e cila po rritej, si edhe për të na aftësuar si kishë që të arrinim komunitetin tonë për Krishtin. Ne nuk kishim para (kisha nuk ishte në gjendje as të më jepte mua, pastorit të tyre, një rrogë), por kur e ndava vegimin me burrat e kishës, ata e pranuan si diçka e cila vinte nga Zoti dhe u përkushtuan, bashkë me mua, që ta bënin realitet atë. Ditën e nesërme, pasi e kisha ndarë vegimin, Çarli erdhi tek toka e kishës me një makineri të madhe nga ato që gërmojnë dhe heqin dheun. Unë isha brenda në kishë, dhe mund ta ndieja tokën që gjëmonte. Kur dola jashtë dhe pashë Çarlin brenda asaj makinerie, i bërtita: “Çarli, çfarë po bën kështu?”. Ai buzëqeshi vesh më vesh dhe tha: “Do fillojmë të gërmojmë vendin për të ndërtuar themelet e kishës së re. Perëndia do të sigurojë!”. Ai ishte besimi i mishëruar, dhe bashkë me besimin e tij, ai rriti edhe besimin tim. Përgjatë vitit në vazhdim, ne pamë mrekullitë që ndodhnin njëra pas tjetrës, dhe 12 muaj më vonë, ishim ulur, po këndonim dhe po luteshim në një ndërtesë kishe fringo të re, e cila ishte thuar 100% e paguar. Megjithatë, nuk do ta harroj kurrë fytyrën e Çarlit kur ai tha me zë të lartë: “Do të fillojmë!”. Si një udhëheqës shumë i ri dhe i pasprovuar, kisha nevojë për forcën, përvojën dhe inkurajimin që m'u dha atë të hënë në mëngjes nga një burrë me emrin Çarli. **Ai ishte një gjigant në mesin tonë.**

➤ **Një burrë me emrin Çarls Dove.** Ky burrë është babai im. Ai e quan veten “plaku”. Kur isha i vogël, e kam parë atë përgjatë viteve ndërsa riparonte ndërtesën e kishës kur pikonte çatia, ndërsa rregullonte karriget ndërkohë që bashkësisia jonë filloi të rritej, ndërsa menaxhonte financat e kishës me integritet dhe llogaridhënie, ndërsa shërbente si një dhjak për skuadrën e udhëheqësve, ndërsa përgatiste ushqim për ungjilltarët dhe misionarët që vinin për vizitë dhe ndërsa kryente punët e rëndomta të kopshtarisë, me barin dhe lulet, në ambientet e kishës. Ai gjithashtu shkonte për vizitë tek të sëmurët, inkurajonte pastorin tonë dhe jepte të dhjetat e

Zotit dhe ofrimet e familjes sonë muaj për muaj, edhe atëherë kur kohët ishin të vështira dhe paratë nuk ishin të mjaftueshme. Ai më mësoi si t'i lutem Zotit dhe si të ndërmjetësoj në lutje, jo duke më dhënë mësim nga ndonjë libër apo “duke më thënë” se si të lutem, por unë e përvetësova këtë aftësi, duke e dëgjuar babanë tim nga dhoma e gjumit e shtëpisë sonë të vogël. Ai lutej natë për natë gjatë fëmijërisë sime, për të 17 vitet që unë jetova nën të njëjtën çati me të. Ai ishte me të vërtetë një njeri i Fjalës së Perëndisë, dhe nuk i ikte kurrë një ditë pa u ulur dhe pa lexuar Fjalën e shenjtë të Perëndisë, zakonisht me zë të lartë. Ai jetoi, eci dhe praktikoi një dashuri të pastër dhe besnike për kishën e Atit dhe për pastorin, të cilin i shërbente. Të gjitha këto, ai i bëri pa u ankuar dhe pa pritur të merrte vëmendjen e ndokujt. **Ai ishte një gjigant në mesin tonë.**

Të gjithë këta burra kanë ndikuar në pikëpamjen time personale, në praktikën e shërbesës dhe në udhëheqjen e trupit të Krishtit. Pavarësisht edukimit që kam marrë nga shkolla biblike dhe nga trajnimi në seminarin biblik, po mos të kishte qenë për këta burra dhe për kujdesin e tyre besnik ndaj detyrave që ata kishin në kishë, unë nuk do të isha ky që jam. Jam shumë mirënjohës për secilin prej tyre dhe ia kam shprehur secilit falënderimin tim në kohën e duhur.

A mund t'ju inkurajoj, si një bashkudhëheqës me ju, që të jeni shumë të vëmendshëm për të parë “gjigantët” në kontekstin tuaj? Për të qenë i sinqertë, ata nuk janë gjithmonë njerëz që “të mbajnë me muhabet” apo që zënë shoqëri kollaj. Megjithatë, besnikëria e tyre ndaj punës, veprave, të dhënies dhe lutjes po i mban lart duart tuaja të fuqisë dhe vizionit, ndërkohë që ju punoni për të përmbushur thirrjen tuaj si mësues dhe pastor mes tyre. Sigurohuni që ata t'i dëgjojnë fjalët tuaja të inkurajimit, dhe kur Zoti i sjell ata në mendjen tuaj, shqiptojini emrat e tyre në lutje përpara Zotit. Si shërbenjës të ungjillit jeni shpallur për të qenë një dhuratë për trupin e Krishtit. Këta “**gjigantë në mesin tonë**” janë dhurata të Zotit për ju personalisht, ndërkohë që shërbeni.



JEFFREY W. DOVE,

Life Publishers International,
Aleanca Biblike e Asambleve
të Perëndisë



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

Email: KTUSHqiperi@gmail.com ♦ Celular: 0694068956

KTU përgatit pastorë, misionarë dhe shërbyes me anë të trainimit biblik për të shkollur ungjillin dhe themeluar kisha në fuqinë e Frymës së Shenjtë.



*"Sot me bindje
mund t'ju them, se për
ju që keni një thirrje për
t'i shërbyer Zotit, atëherë
KTU është vendi i duhur
për të filluar, kuptuar dhe
ndjekur më së miri
thirrjen tuaj.*

Genci Zeka

*"I jam vërtet
mirënjohëse Perëndisë
për të gjithë inkurajimin,
ndikimin dhe investimin
ndërtues që KTU ka
pasur për jetën dhe
shërbesën time."*

Leonora Kodra

*"Koha në kolegji
më ka ndihmuar të mësoj
por dhe të njoh veten më
shumë. Mendoja se isha
një student i pjekur, por
kam mësuar se sa shumë
kam nevojë të rritem."*

Artan Ramaj

Kampi i Adoleshentëve 1-6 Korrik 19

Në Eden Park...
Mosha 13-18 vjeç

- ✓ Adhurim
- ✓ Mësim Bible
- ✓ Larje në pishinë
- ✓ Lojëra argëtuese
- ✓ Miqësi me njëri tjetrin

Kontaktoni: Pastor Emanuele Mango
Email: elihu@live.it ♦ Cel: 069 609 5810

